

**Subvencionimi,
modeli që ka
nxjerrë nga
kriza edhe
fqinjët**

Fq.4



**QEVERIA
AKUZON**

**Ivanovi
i fsheh
shpenzimet**

Fq.6



**Tregu
i votës**

**Arben
Taravari**

Fq.11



Koha

www.koha.mk



**KOHA për
enigmë**

Fq.12-15

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3395 · E shtunë/e diel, 23-24 qershor 2018

12°C | 22°C

15 DEN

FORUM

**Sheh rrushi
rrushin...
(e Shqipërisë)
dhe prishet!**



A keni dëgjuar për rregullën gramatikore "kështu e bëjnë në Shqipëri"? Sigurisht nuk keni dëgjuar, por ndoshta pa vetëdije jeni bërë rob të saj! Së pari, t'ua tregoj lexuesve një anekdotë për një të krishterë që kishte dashur të bëhet mysliman. Hoxha ia kishte bërë duanë dhe e kishte mësuar si të falet. Kur kishte parë se e ka pak si vështirë ta kuptonte sa herë duhej të bie në sexhde e të çohet në këmbë, hoxha i kishte dhënë një këshillë...

Fq.10

GLOBI

**Mund të
humbasim
shumicën par-
lamentare**

Fq.17

EDITORIAL

**Fabula e një
rrëfimi të ri
bashkëveprues**

Fq.2



SHQIPTARËT SHUMË PAK E SHFRYTËZOJNË IPARDIN

POLLOGU E FUNDIT TE FONDET EVROPIANE



Shkaqet kryesore për nivelin kaq të ulët të shfrytëzimit të fondeve bujqësore evropiane në Tetovë dhe Gostivar, ku gravitojnë dhjetëra fshatra, sipas përfaqësuesve të fermerëve, janë çështjet e pazgjidhura pronësore-juridike të tokës bujqësore dhe druajtja e bujqve të kësaj ane se sa me të vërtetë do të realizohen deri në fund marrëveshjet e nënshkruara

Fq.7

Faktori shqiptar ndikoi në marrëveshjen Zaev-Cipras

Tiranë, 22 qershor - Ish-ambasadori grek në Shqipëri dhe në Maqedoni, Alexandros Mallias, vlerëson se faktori shqiptar në Maqedoni është shumë i rëndësishëm dhe ishte pikërisht ai që shtyu qeverinë Zaev drejt kërimit të një zgjidhjeje dhe marrëveshjeje me Greqinë. Në një intervistë për "Tema TV", Mallias shprehet se Greqia dhe Shqipëria janë në një fazë të pjekur të bisedimeve mes tyre, por zgjedhjet që duhen

bërë janë kompromise të vështira. "Ekzistojnë zgjidhje të vështira kompromisi dhe ky kompromis duhet përkrahur. Roli i faktorit shqiptar në marrëveshjen e Prespës, mes Maqedonisë dhe Greqisë është shumë i rëndësishëm. Unë besoj dhe veproj, nxis promovimin e marrëdhënieve të Greqisë me Shqipërinë, ashtu dhe me Kosovën. Greqia për 25 vjet ka marrëdhënie të ngushta me...

Fq.3



EDITORIAL

FABULA E NJË RRËFIMI
TË RI BASHKËVEPRUES

Emin AZEMI

Kur shqiptarët ankoheshin në të kaluarën se statusi "qytetar" si kategori kushtetuese nuk i bën gjitha që lumtur, kishte reagime të furishme që kundërshtonin këtë mospajtim, duke thënë se të jesh "qytetar" në një shtet nuk është ndonjë hendikep, përderisa ky status nuk rrezikon homogjenitetin dhe unitaritetin e shtetit, ndërkohë që statusi i "popullit shtetformues" ishte i rezervuar ekskluzivisht vetëm për maqedonasit. Tani kur Shkupi dhe Athina kanë nënshkruar një Marrëveshje që rregullon marrëdhëniet reciproke dhe flak të gjitha dubiozat rreth emërimit të shtetit, janë zgjuar shpirtrat kundër kësaj Marrëveshjeje, duke e cilësuar atë "asimetrike", që mohon atributin etnik të maqedonasve dhe që legjitimon shpërbërjen e kontinuitetit të shtetësisë. Koncepti "qytetar" nuk po iu pëlqen tani atyre që dikur ua zinin për të madhe shqiptarëve se pse nuk po ndjehen mire në "këmbësor" e këtij statusi. Tani po del se të jesh "qytetar" nuk qenka shumë lezet.

Kundërshtarët e Marrëveshjes së Prespës vetëm tani po arrijnë ta kuptojnë sikletin e shqiptarëve, por këtë nuk e thuan haptazi. Ata, tani po japin leksione falas nga fusha e së drejtës, duke na bindur se shteti që deri dje quhej Maqedoni ka humbur brenda vetes shtyllën bartëse të sovranitetit ("populli maqedonas"), dhe pa këtë shtyllë, shteti me emrin e ri nuk ka gjasa të qëndrojë në këmbë. Kjo lagje mendimtarësh edhe në të kaluarën ishin munduar të na bindin se maqedonasit e sotëm kanë histori mijëra vjeçare, me Aleksandrin e Madh si birin më të madh që ka nxjerrë ky popull. Të gjithë ata që merrnin mundin të sqaronin shkencërisht se ky popull që vetes i thotë maqedonas janë sllavë, të ardhur pas shek. të 6-të, të e. së re, se gjuha dhe gramatika e këtij populli ishin kodifikuar tek pas Luftës së Dytë Botërore, me ASNOM-in si "amza" që kishte prodhuar të gjitha derivatet e shtetësisë së këtij populli, kualifikoheshin si njerëz me epitete më negative. Ende nuk e kemi të qartë se pse ishte fyerje të quheshe "sllavo-maqedon", ndërkohë që mekanizmi i shndërrimit të historisë në legjenda dhe mite, po punonte me të madhe në shpëlarjen kolektive të trurit. Po të vazhdonte edhe më tej kjo shpërlarje, gjeneratat e ardhshme do ta kenë patur vështirë ta kuptojnë se si ndodhi që një popull sllav të mos përdor në komunikimin e përditshëm asnjë fjalë nga fjalori i vjetër i gjuhëve antike. Si ndodhi që në njërin anë propagohej antikiteti, kurse në anën tjetër nuk kishte kurrfarë kontinuiteti etnik, arkeologjik, gjuhësor në relacionin antikë – kohë modern që do të dëshmonte se këta maqedonasit e sotëm janë pasardhës direkt të maqedonasve antikë.

Lajthitja që lidhet me gjeografinë, duke e huazuar nocionin "Maqedoni" si tapi e një populli që nuk kishte kurrfarë lidhje me antikën, u mundua të na shitet si program nacional e shtetëror që dote duhej të shërbente si platformë për të zgjidhur kontestet e brendshme dhe të jashtme. Me këto iluzione qëndroi shumë vite në pushtet Gruevski dhe ishte pikërisht fryma e këtij programi nacional-shtetëror ai që shembi të gjitha urat e bashkëpunimit me faktorët ndërkombëtar për tejkalimin e kontesti me Greqinë.

Tani kur Marrëveshja u arrit dhe u ratifikua në Parlament, po gjenden sërisht arsye e motive për ta kontestuar atë. Zakonisht në këto raste gjithmonë do të gjenden njerëz që do të gjejnë anë të dobëta të çfarëdo lloj marrëveshjeje dhe anë të tilla të dobëta ka edhe Marrëveshja e Prespës. Por, shpirtngushtësia për të pa efektet pozitive të kësaj Marrëveshjeje historike nuk po i lejon kundërshtarët të nxjerrin konkluzionin logjik: E ardhmja e Maqedonisë do të ishte më e mirë pa këtë Marrëveshje, apo e kundërta, të gjithë ventilat që mbanin të mbërthyer energjitë e brendshme, tani me këtë Marrëveshje do të hapen dhe do të përkthehen në një kreativitet bashkëpunues me botën, që ndryshe i bie që Maqedonia e Veriut, bashkë me qytetarët e saj, me gjuhët e saj dhe me traditat e saj, bëhet pjesë e një familjeje më të madhe europiane, ku vlerat e përbashkëta, e jo pallavat mitologjike, shkruajnë fabulën e një rrëfimi të ri bashkëveprues e bashkërendues.

SI LINDI KËNGA "MORA UDHË KAH
MANASTIRI"?

"Pikërisht para 30 vitesh duke përgatitur disa emisione në Radio Prishtinë për të shënuar 80-vjetorin e Kongresit të Manastirit, më lindi ideja ta bëj edhe një tekst kënge në këtë temë, në mënyrë që kjo datë e madhe historike të marrë fuqi edhe më të madhe në ato rrethana kur në ish-Jugosllavi një shtet i tërë po e luftonte shqiptarizmin. Një vit më parë, po për këngën shqipe, pushteti në Maqedoni kishte dënuar me burg edhe këngëtarët tona Shkurte Fejza dhe Shyhrete Behluli. Dhe si reagim, këngën ia ofrova Shkurtës, e cila e këndoi dhe e realizoi me sukses po në Produksionin e atëhershëm të RTP-së. Kënga mori shpjet krah dhe, mendova që si hit i vitit do të ketë jetën e shkurtër. Por kjo këngë, për njësinë themelore kombëtare, për alfabetin e gjuhës shqipe, tashmë bëri një jetë të gjatë tridhjetëvjeçare dhe u këndua nga shumë këngëtarë pas Shkurtës, si nga Ismet Peja, Hava Betkeshi dhe nga Erzana dhe Bleoona Aliu. Derisa osmanishtja e vjetër po vdiste si gjuhë e Perandorisë ashtu si kishte vdekur edhe latinishtja, gjuha e gjallë shqipe po bëhej me alfabet dhe po fillonte të bëhej gjuhë e kultivuar, edhe pse me shekuj ishte e ndaluar, madje edhe me ligje si në Perandorinë Osmane. Ligjet e ndalimit të gjuhës shqipe vazhduan edhe nën pushtimin e fqinjve serbë e grekë, por njësia jonë kombëtare, mori udhë të mbarë", ka përkujtuar në profilin e tij në Facebook, 30 vjetorin e kësaj kënge, autori Faruk Tasholli.

PROTESTA PËR TEATRIN, MENDIME TË
SHKARTISURA

"Që nga koha e Athinës klasike, teatri ka shërbyer si hapësira magjike, ku riprodhohet qyteti. Protesta e tanishme po i jep Tiranës një hapësirë po aq magjike, ku të riprodhohet teatri i mohuar. Kjo edhe ngaqë në krye të protestës kanë dalë aktorët: Aktori në rolin e protestuesit është aktori që e vazhdon teatrin në rrugë. Aktori që proteston deri dje njihej nga publiku duke mos qenë vetja; ndërsa tani konstituohet si person publik, duke luajtur publikun. Lëvizja e tanishme është performim skenik i publikës. Por ka edhe më. Në dinamikën e një shfaqjeje teatrale, aktori zakonisht është ai që e vë lirinë e vet personale në dispozicion të regjisorit. Në fjalët, emocionet, gjestet dhe lëvizjet e tij aktori është i skriptuar, pa çka se e realizon veten si person mu në distancën e imët mes tekstit (kodit) dhe njeriut (teje si spektator). Por aktori që proteston për teatrin, e ka refuzuar tashmë Regjisorin. Tek ky aktor refuzues, publiku sheh të manifestuar veten, në dramën e sotme të politikës. Lëvizja e tanishme nuk është thjesht për të shpëtuar një ndërtesë, as për të mbrojtur një truall publik nga abuzimi. Është më shumë se kaq: është kryengritje kundër arrogancës së Regjisë", ka komentuar zhvillimet e fundit rreth prishjes së godinës së Teatrit Kombëtar në Tiranë, eseisti dhe shkrimtari Ardian Vehbiu.

MEDIACitate

HARADINAJ
DETYROHET
TA RESPEKTOJË
VLERËSIMIN
E BE-së PËR
PAGAT

Kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj në një konferencë për media pas mbledhjes së qeverisë ka thënë se Qeveria e Kosovës e respekton vlerësimin që ka bërë BE-ja për rritjen e pagave. "Ne kemi pas mundësi me taku një delegacion nga BE në kohën kur ka ardhur. Jam thëllë i bindur që materia e raportit që kemi dertuar edhe substanciale. Ne e respektojmë vlerësimin e BE-së për rritjen e pagave. Pas kësaj do të pasojë Ligji për nivelizimin e pagave që do të i rregullojë këto".

Ai tutje tha që nëse ministri i Financave, Bedri Hamza dëshiron të bëhet "burri më i mirë i Kosovës", le ta përshpejtojë Ligjin për nivelizimin e pagave. I pyetur rreth idesë së presidentit Thaçi që në raundin e fundit të bisedimeve me Serbinë të diskutohet edhe demarkimi me këtë shtet, Haradinaj tha se demarkimi me Serbinë duhet të ndodhë, por se nuk ka komentuar se kur mund të ndodhë. "Unë i pata ofruar edhe Parlamentit një platformë. Është mirë që partitë politike të kenë një komunikim më të saktë për fazën finale të dialogut. Demarkimi është një proces i rëndësishëm që ndodhë në vende por nuk kisha thënë më shumë për atë se çka edhe kur do të ndodhë", ka thënë Haradinaj. Ndryshe, ministri i Financave, Bedri Hamza nuk ka pranuar të marrë pagën me rritje dhe retroaktive. Këshilltari i tij, Lulzim Rafuna, ka thënë për portalin Koha.net se shefi i tij së bashku me këshilltarët kanë refuzuar të marrin pagën me rritje për të cilën vendosi kryeministri Ramush Haradinaj. I pyetur nëse ministria ka forcë ligjore për të penguar rritjen e pagave të qeverisë, Rafuna ka thënë se kjo gjë nuk mund të bëhet pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

(Gazeta Zëri, 22 qershor)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

ÇFARË RËNDËSIE PATI KUVENDI I GJIROKASTRËS?

Kuvendi i Gjirokastrës (23 korrik 1880) ishte një nga kuvendet kombëtare më të rëndësishëm të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Çështja themelore që trajtoi ishte autonomia e Shqipërisë, koha e shpalljes dhe mënyra e arritjes së saj. Kuvendi vendosi që, koha më e përshtatshme për të shpallur autonominë e Shqipërisë do të

ishte çasti kur Perandoria Osmane të pranonte pushtimin e trojeve shqiptare nga ushtritë greke e malazeze. Në këtë rast Lidhja Shqiptare e Prizrenit do ta shpallte veten qeveri të përkohshme. Qeveria e përkohshme do të mernte të gjitha masat për t'i dhënë fund sundimit osman në Shqipëri.



Merkel fuqishëm mbështet marrëveshjen me Greqinë

Shkup, 22 qershor - Kryeministri i Qeverisë së Maqedonisë, Zoran Zaev, pranoi letër urimi nga kancelarja gjermane Angela Merkel, ku ka shfaqur gëzimin e saj për arritjen e marrëveshjes lidhur me kontestin për çështjen e emrit ndërmjet Greqisë dhe Maqedonisë, njoftoi pres qendra e Qeverisë. "Kjo marrëveshje e hapë rrugën për marrëveshje historike, edhe juve dhe Qeverisë tuaj ju uroj për arritjen e këtij suksesi. Gjermania me interes të madh do të ndjekë realizimin e kësaj marrëveshje dhe do ta mbështesë fuqishëm, thuhet në letër urimin deri te kryeministri Zaev nga kancelarja gjermane Angela Merkel.

MALLIAS PËR MARRËVESHJEN PËR EMRIN E MAQEDONISË

FAKTORI SHQIPTAR NDIKOI PËR MARRËVESHJEN ZAEV-CIPRAS

"Ekzistojnë zgjidhje të vështira kompromisi dhe ky kompromis duhet përkrahur. Roli i faktorit shqiptar në marrëveshjen e Prespës, mes Maqedonisë dhe Greqisë është shumë i rëndësishëm. Unë besoj dhe vepro, nxis promovimin e marrëdhënieve të Greqisë me Shqipërinë, ashtu dhe me Kosovën. Greqia për 25 vjet ka marrëdhënie të ngushta me partitë shqiptare të ish-republikës Jugosllave të Maqedonisë, dhe së shpejti shpresoj Maqedonisë Veriore...", tha Mallias



është shumë i rëndësishëm. Unë besoj dhe vepro, nxis promovimin e marrëdhënieve të Greqisë me Shqipërinë, ashtu dhe me Kosovën. Greqia për 25 vjet ka marrëdhënie të ngushta me partitë shqiptare të ish-republikës Jugosllave të Maqedonisë, dhe së shpejti shpresoj Maqedonisë Veriore. Është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi midis

Shqipërisë dhe Greqisë, shqiptarëve dhe grekëve, është një faktor vendimtar", tha Mallias. Ai flet edhe për njohjen e Kosovës nga shteti grek. Sipas tij, marrëdhëniet e Greqisë me Kosovën janë të mira dhe janë kryesisht komerciale e financiare, por sipas tij kjo nuk është e mjaftueshme.

"Marrëdhëniet tona me Ko-

sovën janë të mira, ato tregtare, financiare në aspektin e lëvizjes së shtetasve, por për mua kjo nuk mjafton. Unë jam sinqerisht pro njohjes së Kosovës, dhe kjo të jetë rezultat jo i një deklarate të ministrisë, por i një pakti dypalësh. Besoj në atë që thoshte Gandi i Ballkanit, udhëheqësi i Kosovës, Ibrahim Rugova, se Kosovën dhe Greqinë nuk i ndan as etnia, as historia dhe as gjeografia. Kjo është shumë e rëndësishme, pasi zakonisht problemet mes vendeve i kanë rrënjët te historia dhe gjeografia", tha Mallias për "Tema TV". Mallias shpjegoi se marrëveshja e Prespës ishte një marrëveshje e vështirë për të dyja vendet dhe që ka krijuar shumë tension në Maqedoni. Ai rithekson se pas kësaj marrëveshje ka shumë tension në të dy vendet, por që duhet parë konkretisht se si mund të rregullohet situata dhe më pas të fillojnë bisedimet për Kosovën.

Holanda dha dritë të gjelbër për bisedime me Maqedoninë

Hagë, 22 qershor - Parlamenti holandez dha dritë të gjelbër që Maqedonia të fillojë bisedime me Bashkimin Evropian. Me vendimin e Parlamentit, Këshillit Evropian pritet të votojë "për" hapjen e bisedimeve për anëtarësim me Maqedoninë gjatë takimit të caktuar për më 28 dhe 29 qershor, publikojnë mediat holandeze. Një pjesë e tyre e citojnë Piter Omtcpi, i cili është anëtar i grupit parlamentar i cili e kish vizituar Shqipërinë në maj me qëllim që nga afër të njohet me situatën në atë shtet. Në lidhje me Maqedoninë ai thotë se situata për hapjen e bisedimeve për anëtarësim është shumë e komplikuar për shkak të referendumit që pritet për sqarim për emrin e ri të shtetit. Parlamenti holandez bllokoi hapjen e bisedimeve për anëtarësim të Shqipërisë me Bashkimin Evropian. Hapi është ndërmarrë para samitit të BE-së së javës së ardhshme kur Tirana pret të marr leje për fillim të bisedimeve për anëtarësim. Më shumë se gjysma e deputetëve, 76 nga 150 përfshirë edhe deputetët të cilët e mbështesin qeverinë e kryeministrit Mark Rute bllokuan fillimin e bisedimeve të Shqipërisë me BE-në.

Tiranë, 22 qershor - Ish-ambasadori grek në Shqipëri dhe në Maqedoni, Alexandros Mallias, vlerëson se faktori shqiptar në Maqedoni është shumë i rëndësishëm dhe ishte pikërisht ai që shtyu qeverinë Zaev drejt kërkimit të një zgjidhjeje dhe marrëveshjeje me Greqinë. Në një intervistë për "Tema TV", Mallias shprehet se Greqia dhe Shqipëria janë në një fazë të pjekur të bisedimeve mes tyre, por zgjedhjet që duhen bërë janë kompromise të vështira.

"Ekzistojnë zgjidhje të vështira kompromisi dhe ky kompromis duhet përkrahur. Roli i faktorit shqiptar në marrëveshjen e Prespës, mes Maqedonisë dhe Greqisë

VENDIMI PËR REFERENDUMIN TË JETË I PËRBASHKËT

Shteti duhet të marrë vendim të përbashkët për referendum. Të gjithë kanë të drejtë në debat, shteti duhet bashkërisht të marrë vendim dhe tentimet duhet t'i bëjmë së bashku duke u harmonizuar me partnerët e koalicionit lidhur me këtë çështje jashtëzakonisht të rëndësishme si referendum. Ky është proces dhe duhet edhe pushteti edhe, opozita edhe partnerët e koalicionit të harmonizohen, deklaroi dje kryeministri Zaev. Sipas tij, në procesin në confirmimin e çështjes së referendumit do të definohet edhe kjo nëse referendumit do të jetë obligues apo konsultativ. "Për atë që pajtohem me

opozitën është se referendumit duhet të jetë i obligueshëm, ndërsa së bashku duhet të konfirmojnë nëse do të jetë konsultativ apo obligues nga shkaqe nga të gjitha këto porosi të cilat kohët e fundit dërgohen lënë përshtypje se dikush dëshiron ta bllokojë Maqedoninë. Flas për referendum të obligueshëm nëse të gjithë 50 për qind plus një qytetar dalin dhe e mbështesin referendumin, detyrë absolute e çdo qytetari është që ta respektojë vendimin dhe tekstualisht të adhurohet, përveç nëse nuk është negativ. Unë nuk besoj se kjo është e mundur sot", shtoi Zaev.

SHAUSBERGER I DREJTOHET VENDEVE ANËTARE TË BE-së

TË NISIN NEGOCIATAT ME MAQEDONINË

Vjenë, 22 qershor - Vendet anëtare të BE-së, ndërsa para se gjithash "skeptikët dhe penguesit" e Francës, Holandës dhe pjesërisht nga Gjermania, në Samitin e Unionit javën e ardhshme, duhet ta pranojnë përparimin e arritur me firmosjen e marrëveshjes mes Shkupit dhe Athinës dhe të japin dritë të gjelbër për fillim të negociatave inkuadruese me Maqedoninë, konsideron Frank Shausberger, këshilltar special i eurokomisarit për zgjerim dhe politikë fqinjësore, Johannes Han. Marrëveshja për kontestin shumëvjeçar të emrit të Maqedonisë mund të shkaktojë numër të madh të pasojave pozitive për rajonin dhe tërë Evropën, vlerëson Shausberger. Në tekst për gazetën



autriake "Prese", ai thotë se suksesi i marrëveshjes mes Maqedonisë dhe Greqisë do të thotë edhe confirmim se BE-ja mund të ketë rol të ndërmjetësuesit në zgjidhjen e konflikteve edhe krahas vështirësive të mëdha në radhët personale. Strategjia e BE-së për zgjerim e prezantuar më 5 shkurt të këtij

viti, sipas Shausberger, shkaktoi dinamikë në vendet e Ballkanit Perëndimor që nuk duhet të nënçmohet.

"Marrëveshja për emrin derisa ratifikohet, do të shkaktojë një seri të pasojave. Për Maqedoninë do të mënjanohe pengesat e rrugës drejt fillimit të negociatave inku-

druese me BE-në. Është e mundur hapja e negociatave edhe me Shqipërinë edhe pse Tirana së pari duhet të tregojë seriozitet në lidhje me reformën e gjyqësisë dhe luftën me korrupsionin. Vënia fund kontestit mes Maqedonisë dhe Greqisë mund të japë impuls të ri edhe në dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës, ndërsa do të ketë ndikim pozitiv edhe në shumë çështje të pazgjidhura mes popujve në Bosnjë e Hercegovinë" thotë Shausberger.

Ai thekson se zgjidhja e problemeve bilaterale mes vendeve të Ballkanit Perëndimor kandidata për anëtarësim në BE është kyç dhe parakusht i pavërejtur për eurointegrimin e tyre, sepse Unioni nuk dëshiron konflikte

"Strategjia për zhvillimin e sferës mediatike - nevojat sfidat dhe aktorët" ka qenë tema e panelit ku ndër të tjera janë sjellë edhe përvojat e vendeve fqinjë dhe evropiane për mënyrën sesi janë nxjerrë nga kriza mediat e shkruara dhe vizive, por edhe si janë hartuar strategjitë për zhvillimin e tyre afatgjatë

Koha

Evis HALILI

Shkup, 22 qershor - Ekspertë dhe përfaqësues të mediave kanë përsëritur nevojën urgjente për ndërmarrjen e hapave konkretë nga Qeveria për reformat në media, liberalizimi në tregut dhe subvencionimin e tyre gjatë debatit të organizuar nga Instituti Maqedonas i Mediave. "Strategjia për zhvillimin e sferës mediatike - nevojat sfidat dhe aktorët" ka qenë tema e panelit ku ndër të tjera janë sjellë edhe përvojat e vendeve fqinjë dhe evropiane për mënyrën sesi janë nxjerrë nga kriza mediat e shkruara dhe vizive, por edhe si janë hartuar strategjitë për zhvillimin e tyre afatgjatë. Sllovenia dhe Kroacia në vitin 2016 kanë përfutur përkatësisht me nga 94 milionë euro dhe mbi 160 milionë euro, si edhe subvencione direkte dhe indirekte për mediat. Brankica Petković, eksperte e politikave mediale nga Instituti i Paqes në Lubjanë përmes një

KONFERENCË PËR REFORMAT NË MEDIA

SUBVENCIONIMI, MODELI QË KA NXJERRË NGA KRIZA EDHE FQINJËT



sërë shembujve ka thënë se ndryshimet në sistemin e financimit të mediave kanë dhënë rezultate pozitive dhe kanë sjellë ndryshimeve thelbësore në Serbi, Kroaci..., ku në pjesa më e madhe e këtyre strategjive janë hartuar si pjesë e politikave të qeverive të këtyre vendeve për anëtarësimin në BE. Duke iu referuar situatës ku gjenden mediat në Maqedoni, ku ende nuk ka përfunduar procesi i reformave, Petković ka vënë në dukje se qeveria duhet të reagojë për të mos lejuar mbylljen e mediave dhe përkeqësimin e situatës.

"Në hartimin e strategjisë për mediat duhet të përfshihen ekspertët më të mirë të mundshëm. Për shembull, Ministria e Kulturës

e Kroacisë ngriti një grup më 48 anëtarë që punuan për strategjinë, në Slloveni janë zhvilluar me mijëra debate deri në hartimin e strategjisë. E njëjta gjë duhet të ndodhë edhe këtu, duhet të angazhohen ekspertët më të dalluar nga këto sfera, por edhe paralelisht të punohet jo vetëm për këto ndryshime sistematike, por edhe për përmirësimin e krizës ku ndodhen mediat. Asgjë nuk mund t'i lihet spontanitetit, por duhet të punohet sistematikisht", ka thënë Petković. Disa prej modeleve që mund të ndjekë Maqedonia, e cila prej vitit 2005 nuk jep asnjë lloj asistence financiare, për subvencionimin e mediave në momente krize i ka përmendur kryetari i Asociacio-

nit të mediave të shkruara, Lirim Dullovi, botues i KOHA. "Franca ka akorduar 1 miliardë e 238 milionë euro, Gjermania, 528 milionë, Italia 661 milionë, Britania e Madhe 748 milionë, SHBA 804 milionë, madje Finlanda i ndihmonte me mediat e shkruara me 315 milionë euro në vit. Tek ne prej 13 vitesh nuk jepet asnjë lloj ndihme. Pse? Sepse ekspertët ende kanë dilema nëse duhet t'i ndihmohet kësaj industrie, ose jo.... Zgjidhjen më të mirë e ofrojnë gjithmonë ato për të cilët hartohen këto masa. Askush më mirë se prej nesh nuk e di se çfarë na duhet, cilat janë rregullat e lojës së ndershme që nuk na konfrontojnë me asnjë media. Kërkesat tona ia kemi drejtuar Qe-

verisë, e cila tani e ka shansin që njëherë e përgjithmonë t'i heqë kanxhat nga mediat përmes miratimit të modelit të propozuar, për të cilin akoma s'kemi asnjë sinjal", ka thënë Dullovi. Gazetari Mirçe Jovanovski vëren se qeveria edhe pse deklarativisht nuk është kundër subvencionimit, prapëseprapë nuk ka një koncept të qartë sesi do ta realizojë. Duhet të precizojë se cilët sektorë të sferës mediatike duhet të fuqizohen, si mediat e shkruara, mediat e bashkësive etnike..., e të tjera. Drejtori i Agjencisë së shërbimeve audiovizuale, Zoran Trajčevski ka potencuar se gjenden në një fazë delikate, ku institucioni i ka opsionet e mbyllura për të vepruar, përderisa ende nuk është miratuar korniza ligjore. "Jemi në një periudhë ku as ne dhe as mediat nuk dinë ç'të bëjmë. Në mungesë të një kornize ligjore, strategjia konkrete është vështirë të veprojë. Në ndërkohë kemi propozime, siç është ai i subvencionimit të mediave të shkruara, por deri sa të hartojë qeveria strategjinë kam frikë se nuk do të ketë se kë të financojë", ka thënë Trajčevski. Gjatë konferencës, drejtoresha e IMM, Bijlana Petkovska, ka prezantuar edhe tre publikime, si pjesë e projektit për reformat në media që financohet nga BE.

QË TË ZGJIDHET NJË PJESË E PROBLEMIT ME REGJISTRIMIN E NXËNËSVE

"PANÇE KARAGJOZOV" KËRKON KËMBIM TË PARALELEVE

Përgjegjësi i paraleleve me mësim në gjuhën, Sherif Selimi, thotë se ka kërkuar nga Ministria e Arsimit që në vend të paraleles së përkujdesësve, e cila nuk ka nxënës të interesuar, të formohet një paralele më shumë e drejtimit të infermierisë

Koha

Laura PAPANIKU

Shkup, 22 qershor - Nxënës të mirë të shkollave nëntëvjeçare rrezikojnë të mbesin pa një vend të mirë regjistrimi në shkollat e mesme. Në vrapin për tu bërë infermierë, stomatologë, farmacistë dhe shkëlqyeshëm në afatin e parë të regjistrimit kanë mbetur pa fituar

një vend në paralelet shqipe të shkollës së mesme "Pançe Karagjozov" në Shkup. Pjesa dërmuese e kësaj kategorie nxënësish, që bazuar në rezultatin e pikëve të përlogaritura nga suksesi i notave të arsimit fillor i bie të jenë nxënës të mirë, kanë konkurruar në drejtimin e infermierisë (motrave medicinale). Por në bazë të Konkursit që ka shpallur Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) për regjistrimin e nxënësve në vitin shkollor 2018/2019, për këtë drejtim në paralelet me gjuhën shqipe janë planifikuar vetëm 102 vende, pra tre paralele. Nga ana tjetër, interesimi i nxënësve për këtë lloj shkollimi është dyfish më i madh. Vetëm në paraqitjen e parë të afatit të qershorit, për këto tre paralele kishin konkurruar 222 nxënës, prej të cilëve vetëm tre nuk i plotësonin kushtet, pra kishin më pak se minimumi i pikëve të kërkuara me Konkurs. Listat e publikuara me emrat e nxënësve që kishin konkurruar për drejtimin e infermierisë, të pu-

blikuara që të mërkurën në hapësirat e shkollës, tregojnë se krahas 102 nxënësve të pranuar, janë edhe 117, të cilët i plotësojnë kushtet për pranim, kanë mbi 71 pikë, mirëpo gjenden poshtë "vijës së kuqe". Sherif Selimi, përgjegjësi i paraleleve me mësim në gjuhën shqipe në shkollën "Pançe Karagjozov", thotë se interesimi për këtë lloj drejtimi është sa herë i madh. Mirëpo, plotëson më tej ai, numri i paraleleve që na lejohen nga ana e MASH-it është i vogël, vetëm tre paralele. Prandaj, sipas tij, mënyra më e mirë e zgjidhjes së problemit do të ishte këmbimi i paraleleve brenda vetë shkollës apo në kuadër të numrit të përgjithshëm të paraleleve të të gjitha drejtimeve. "Kështu, në vend që të hapim paralelen e drejtimit përkujdesës shëndetësor, për të cilin edhe ashtu nuk ka interesim të mjaftueshëm nxënësish, këtë paralele mund ta kalojmë si paralele të ketër të drejtimit infermieri. Jo se me këtë paralele mund të pranojmë të gjithë ata të cilët kanë konkur-

ruar, sepse janë shumë, por të paktën nuk do të largonim nga shkolla të 34 nxënës të shkëlqyeshëm", pohon Selimi. Për këtë çështje, ai thotë se ka kontaktuar edhe zyrtarët e ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, të cilëve u ka kërkuar të lejojnë këmbimin e paraleleve, pra të mos formohet drejtimi përkujdesës dhe në vend të saj të shtohen paralelet e infermierisë.

Për drejtimin e përkujdesësve, paraleles që ai konsideron se nuk është kush e di sa e nevojshme, pasi një numër i madh i atyre që regjistrohen këtu janë me sukses jo të mirë të notave, deri tani janë paraqitur tetë kandidatë, ndërsa kanë mbetur të lira 26 vende. Madje, gjysma e atyre që u regjistruan vjet në këtë drejtim do ta përsërisin të njëjtin vit shkollimi. Ndërkaq, sipas numrit të nxënësve të paraqitur deri tani, kjo paralele rrezikon të mos formohet, për mungesë të mjaftueshme nxënësish. Për formimin e një paralele, sikurse dihet, nevojiten të paktën 25 nxënës në klasë dhe mak-

simumi 34 nxënës. Që t'ju kërkosh nxënësve kandidatë për në infermieri të transferohen në paralelen e përkujdesësve, nuk tingëllon as etike pasi ata disponojnë nga 71 dhe më tepër pikë, ndërsa për paralelen e përkujdesësve mjaftojnë edhe 30 pikë. Por, përgjegjësi Selimi thotë se mund të gjendet një zgjidhje edhe atë shumë e mirë. "Një paralele të përkujdesësve ka edhe në shkollën e mesme të kimisë "Maria Kiri Skllodovska", ku gjithashtu janë paraqitur shumë pak kandidatë. Kështu që, nëse tetë kandidatët e shkollës sonë dërgohen në paralelen e njëjtë të asaj shkolle, do të krijoheshin numrat për formimin e paraleles dhe në këtë mënyrë do ta kishin të sigurt regjistrimin të dyja palët", propozon përgjegjësi i paraleleve të SHMM "Pançe Karagjozov". Në të njëjtën kohë, sipas tij, do të do të krijoheshin mundësitë që në vend të tre paraleleve infermieri të formohen katër paralele dhe me këtë të pranohen jo vetëm 102 por 136 nxënës.

ZBULIMI DHE POLICIA T'I NDAJË ROLET

DSK ËSHTË KEQPËRDORUR

Drejtori aktual i DSK-së, Goran Nikollovski, për herë të parë publikisht para një numri të konsiderueshëm të personave që kanë qenë viktimë të politikës tendencioze të kësaj drejtorie, të premtën e pranoi se në institucionin që ai e drejton, përgjatë 70 viteve të kaluara kanë ndodhur keqpërdorime

Koha Omer XHAHERI



Shkup, 22 qershor - Përmes transparencës më të madhe, Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim synon kthimin e besimit të popullata. Drejtori i DSK-së, Goran Nikollovski, duket folur për reformat në sektorin e sigurisë në vend, të premtën tha se mes qytetarëve dhe DSK-së duhet të krijohet një lloj bashkëpunimi me të vetmin qëllim - mbrojtjen e sigurisë së shtetit.

"Ne synojmë të jemi në shërbim të qytetarëve përderisa ju brenda kohës të na dilni në ndihmë. Parimi kryesor që dëshirojmë ta përmbushin është ky", tha Nikollovski. Institucionet relevante shtetërore dhe DSK, sipas Nikollovskit, janë të vetëdijshëm se procesi i kthimit të besimit në popull nuk bëhet brenda natës, por se për këtë çështje nevojitet kohë dhe bashkëpunim me opinionin. Zhvillimet dhe aktivitetet që kanë ndodhur brenda DSK-së në të kaluarën, Nikollovski i cilësoi si luftë mes dy koncepteve që ai dhe kolegët e tij dëshirojnë të tejkalojnë.

"Koncepti i parë lidhet me centralizimin e fuqisë dhe tjetri me decentralizimin e fuqisë. Gjatë viteve të kaluara, ka ekzistuar koncepti i parë dhe kjo ka qenë rreziku më i madh për shtetin. Përderisa koncepti i decentra-

lizimit të fuqisë nënkupton që çdonjëri të mbajë përgjegjësi për punët dhe obligimet e veta në këndin e veprimtarisë së tij. Nuk mundet një qendër e fuqisë të vendos për gjithçka në shtet. Për këtë arsye, ne angazhohemi që çdo institucion të marrë përgjegjësi për punën e tyre. Ne si DSK do të mbulojmë punën tonë, e cila kryekëput lidhet me çështjen e sigurisë së shtetit dhe veprat penale kundër shtetit", shtoi Nikollovski.

Drejtori aktual i DSK-së, Goran Nikollovski, për herë të parë publikisht para një numri të konsiderueshëm të personave që kanë qenë viktimë të politikës tendencioze të kësaj drejtorie, të premtën e pranoi se në institucionin që ai e drejton, përgjatë 70 viteve të kaluara kanë ndodhur keqpërdorime. Kësisoj, reformimi i një hierarkike të tillë, sipas tij, nuk do të jetë fare i lehtë të realizohet në të ardhmen, respektivisht për këtë arsye - zbatimi i reformave në sistemin e sigurisë mendohet të bëhet në disa faza.

"Hapin e parë që tanimë e kemi hedhur është marrja e monopolit për përcjelljen e komunikimeve. Marrja e këtyre kompetencave nga DSK nënkupton se çdo organ shtetëror që ka kom-

petenca për përcjelljen e komunikimeve, ka të drejtë të barabartë të shfrytëzimit. Ajo që deri dje ishte primati i jonë, tash e tutje këtë përgjegjësi e ndajmë edhe me institucionet tjera relevante. Pjesa jonë e përcjelljes së komunikimeve do të lidhet vetëm në çështjen e sigurimit të shtetit dhe trajtimit të veprave penale që lidhen me sigurinë e shtetit. Pastaj, largimi i famës se ne jemi 'polici sekrete', është hapi i dytë që synojmë ta largojmë dhe reformojmë. Kjo pritet të realizohet përmes praktikave nga Evropa. Atje, me disa përjashtime të vogla, çdo shërbim i zbulimit është i ndarë nga policia. Në rajon, po ashtu nuk ekziston asnjë shërbim që është pjesë e policisë. Ne jemi shërbimi i fundit në rajon që kemi kompetenca edhe policore. Zbulimi dhe kompetencat policore nuk shkojnë bashkërisht. Kjo është receta e keqpërdorimit të fuqisë. Për këtë arsye, ne do të hapim debat publik, ku presim të marrë pjesë opinionin më i gjerë, ai i ekspertëve profesional dhe të gjitha palët e përfshira edhe shërbimet mike që i kemi dhe ato të BE-së, për të dhënë mendimet dhe vlerësimet e tyre për reformimin e sektorit të sigurisë. Gjithsesi, në fund të ditë fjalën e fundit do ta ketë po-

litika, e cila zgjidhet nga populli në zgjedhje të lira", nënvizoi Nikollovski.

Për ti përmbushur këto qëllime, sistemi i sigurisë, siç tha njeriu i parë i DSK-së, ka nevojë për njerëz me integritet me të cilët do të punohet në ngritjen e përgjegjësi dhe kuptimin të detyrës nga shkalla më e ulët e deri te më e larta. Në këtë pjesë, tha ai, duhet investim i përba-shkët.

Koncepti i kontrollit të sistemit të sigurisë po ashtu paraqet problem të madh për shtetin. Sfidat më të mëdha e organeve shtetërore në të kaluarën ka qenë mungesa e koordinimit. Duke folur për reformat në DSK, Nikollovski potencoi se në të kaluarën, ata kanë qenë në situata kur nuk e kanë ditur se çfarë pune bëjnë sektori i parë, i dytë dhe i tretë. Për këtë arsye, ai vlerëson se duhet zgjidhje sistimore.

Për fund, ai tha se paralelisht me reformimin e DSK-së, duhet të reformohen edhe institucionet tjera që kanë kompetenca për përcjelljen e komunikimeve, gjegjësisht reformat nuk mundet të jetë të plota nëse lihet hapësira që keqpërdorimet në të ardhmen - të kryhen nga ndonjë organ tjetër shtetëror.

KRONIKË

Arrestohet tetovari

Të enjten në ora 16 e 20 minuta, në Bulevardin e "Ilindenit" në Tetovë, nga ana e pjesëtarëve të policisë, me urdhër-arrest të gjykatës së Tetovës, është arrestuar personi A.R. (61) nga Tetova. I njëjti pas dokumentimit të rastit, është dorëzuar në burgun e Tetovës për vuajtjen e dënimit.

Rrahen babë e bir para banesës

Në orët e para të mëngjesit të ditës së premte, në Stacionin policorë në Tetovë, ka ardhur 56 vjeçari S.P. nga Tetova dhe ka denoncuar se në një objekt hotelierik është sulmuar fizikisht djali i tij 23-vjeçarë N.P. Sipas denoncimit, pasi denoncuesi ka dal nga banesa, dhe para hyrjes së pallatit ka vërejtur se janë duke e rrahur djalin e tij, ka reaguuar duke e mbrojtur, fizikisht e kanë sulmuar edhe atë, duke i shkakuar lëndime të dukshme trupore. I njëjti ka kërkuar ndihmë mjekësore në Spitalin klinik të Tetovës. Janë duke u ndërmarrë të gjitha masat dhe aktivitetet, për zbulimin dhe identifikimin e personave, dhe zbardhjen e plotë të rastit

Dy persona plaçkitin shkupjanin

Të enjten rreth orës 12 e 50 minuta, në Stacionin policorë në Gostivar, nga ana e 50 vjeçarit F.I. nga Karposhi i Shkupit, është denoncuar "Plaçkitje" e kryer ndaj tij nga ana e E.N. dhe Xh.N. dhe një person tjetër i panjohur nga Gostivari, të cilët i kanë propozuar që të udhëtojnë bashkë, me veturë në drejtim të Shkupit.

Të njëjti, në autostradën Gostivar-Tetovë pasi e kanë kaluar Stacionin pagesorë të rrugëve, i kanë thënë të dalë nga vetura që ta shtyjë të njëjtën, sepse kanë mbetur në defekt, ndërsa jashtë veturës e kanë sulmuar fizikisht, derisa ka rënë në tokë, dhe nga xhepi i palltos i kanë marrë portofolin në të cilën ka patur dokumentet e tij personale dhe 9 mijë denarë. Më pas, e kanë lënë dhe vetë kanë ikur nga vendi. Në orët e pasdites, nga ana e pjesëtarëve të policisë nga Stacioni policorë Gostivar është arrestuar 23-vjeçari Sh.Gj. nga Prilepi, i cili përkohësisht jeton në Gostivar. Punohet në zbardhjen e plotë të rastit, gjetjen e dy pjesëmarrësve tjerë, ku edhe do të pasojnë padi adekuate.

(U.H)

27 prilli hyn në gjykatë

Shkup, 22 qershor - Këshilli për vlerësimin e akuzës në Gjykatën Penale të Shkupit, të premtën edhe publikisht e ka bërë të ditur se e ka pranuar tërësisht aktakuzën e Prokurorisë për krim të organizuar për ngjarjet e 27 prillit të vitit të kaluar. Përmes një njoftimi për media, GJPSH bën të ditur se pas vendimit të Këshil-

lit Penal, kjo lëndë do të vendoset në sistemin "AKMIS" dhe më pas do t'i ndahet ndonjë gjykatësit sipas sistemit elektronik. Paralelisht me këto zhvillime pritet të dihet edhe data e saktë se kur do të jetë seanca e parë gjyqësore për lëndën më të madhe mbi dhunën e 27 prillit në Parlament me 30 persona të akuzuar, e cila

nga Prokuroria Publike është vlerësuar si "terrorizëm" dhe "organizim terrorist". Nga gjithsej 34 të akuzuar, sipas aktakuzës së Prokurorisë për krim të organizuar, 28 të dyshuar ngarkohen për veprë "terrorizëm", dhe disa tjetër për dhënies të ndihmës. Para dorëzimit të aktakuzës në GJPSH, nga Prokuroria njoftuan

se deputetja Zhaklina Peshevska lirohet nga hetimet për shkak të në mungesës së dëshmive relevante. Njëkohësisht, prokuroria pohon se ka arritur ta gjejë edhe organizatorin, po edhe nxitësin, megjithëse deri më sot nuk e ka treguar as funksionin e tij e as rolin që e ka patur konkretisht më 27 prill. (O.Xh)

VMRO: Më shumë se një vit ekonomia është në zero

Shkup, 22 qershor - Në mungesë të ideve se si ta zhvillojnë ekonominë e Maqedonisë paralajmërimet më të reja janë se vlera e tatimit personal dukshëm do të rritet dhe në vend të tatimit të deritanishëm të sheshtë do të vendosen normave tatimore prej 10.15 dhe 18%. Kjo është akuzë e radhës e VMRO-DPMNE-së drejtuar Qeverisë së Zaevit, ndërsa kjo e fundit akuzohet për tatime të reja ndaj qytetarëve.

"Do të vendosen tatime edhe për të hyrat nga interesi mbi 12.000 denarë. Kjo nënkupton ngarkesë shtesë të sektorit privat që do të ndikojë në rritjen e papunësisë, mbushjen e administratës me kuadro partiakë të LSDM-së të cilët si kastë e privilegjuar do të jetojnë në shpinë të popullit, emigrimi do të rritet, ndërsa kompanitë do ta shpërngulin kapitalin". Nuk ka taksë radiodifuzive, vazhdon më tej kumtesa, megjithatë qytetarët për tre orë parking në Shkup paguajnë 130 denarë dhe të gjithë qytetarët paguajnë lëndë djegëse më të shtrenjta si rezultat i akcizës së rritur të naftës.

"Zoran Zaev kryen eksod ekonomik ndaj shtetit. Më shumë se një vit Zaev është në pushtet, më shumë se një vit ekonomia është në zero, nuk ka vende të reja të punës, nuk ka paga më të larta, nuk ka prosperitet. Mbi 300 milionë euro është borxhi i ri i kartelit në tre muajt e parë të këtij viti. Borxhi në vazhdimësi po rritet. Nuk kalon një muaj, ndërsa karteli të mos e vendosën shtetin në borxh për disa milionë, të cilat askush nuk e din se ku përfundojnë. Kjo është jeta që do t'ua sjellë LSDM-ja, varfëri, zymtësi, tatime të larta, shtet policor...", thuhet në kumtesën e VMRO-DPMNE-së

QEVERIA PËRKUJTON PRESIDENCËN PËR TRANSPARENCË

IVANOVI I FSHEH SHPENZIMET

"Në frymën e vendosmërisë për transparencë dhe llogaridhënie në punën e institucioneve shtetërore dhe funksionarëve të zgjedhur, Qeveria i bën thirrje presidentit t'i vë në kontroll të opinionit informatat dhe të dhënat për shpenzimin e parave të qytetarëve", thuhet në kërkesën e Qeverisë

Shkup, 22 qershor - Presidenti Gjorge Ivanov nuk u përgjigj në ftesën që ta pranojë Veglën për llogaridhënie, me çka refuzon t'i informojë qytetarët për shpenzimet e tij zyrtare, kumtoi pres shërbimi qeveritar. "Ende nuk ka përgjigje nga presidenti Ivanov, në letrën e Qeverisë me propozim dhe Zyra e presidentit ta pranojë Veglën për qeverisje transparente, llogaridhënie dhe komunikuese. Në frymën e vendosmërisë për transparencë dhe llogaridhënie në punën e institucioneve shtetërore dhe funksionarëve të zgjedhur, Qeveria i bën thirrje presidentit të RM-së t'i vë në kontroll të opinionit informatat dhe të dhënat për shpenzimin e parave të qytetarëve", thuhet në kumtesë.

Në letrën e dërguar më 29 maj, ministri i obliguar për Komunikime, Llogaridhënie dhe Transparencë, Robert Popovski, e ka informuar presidentin Ivanov se vegla për qeverisje transparente, raportuese dhe komunikuese është e arritshme për të gjithë funksionarët e zgjedhur të cilët janë të gatshëm t'i lënë në çdo moment në kontroll të qytetarëve edhe informatat dhe të dhënat për shpenzimin e parave të tyre. Në letrën e Qeveria e ka informuar presidentin Ivanov, se përmes Veglës për llogaridhënie, para



qytetarëve deri tani janë publikuar shpenzimet e kryeministrit, të ministrave, të zëvendësministrave, të sekretarëve shtetërorë dhe të sekretarit të përgjithshëm në Qeveri.

Qeveria i obligoi edhe drejtorët dhe zëvendësit e tyre në organet e pavarura të drejtorisë shtetërore, organeve në përbërje të ministrive, dhe të Këshillit inspektues, ndërsa u tregoi edhe drejtorëve të ndërmarrjeve publike, agjencive dhe shoqatave aksionare në pronësi të shtetit t'i publikojnë shpenzimet shtetërore. Më tutje, Qeveria e Maqedonisë e informon presidentin Ivanov se Vegla për qeverisje me përgjegjësi u ishte propozuar edhe kryetarëve të komunave, të cilët,

në ndërkohë, me vendim të Bordit Drejtues të BNJVL-së morën rekomandim të fillojnë ta zbatojnë këtë Vegël dhe t'i publikojnë shpenzimet e bartësve të funksioneve publike në ueb faqet e tyre.

"Ky vendim merr rëndësi ende më të madhe nëse merrtet parasysh fakti se pushteti lokal në Republikën e Maqedonisë tërësisht është i pavarur në krijimin e politikave të tij dhe për atë pranimi i këtij rekomandimi flet për vetëdije të lartë edhe të përfaqësuesve të vetëqeverisjes lokale për kuptim të transparencës dhe raportimit para qytetarëve dhe në nivel të njëjësive të vetëqeverisjes lokale", thuhet në kumtesën e pres shër-

bimit qeveritar.

Edhe pse të gjitha këto informatat, duke i përfshirë edhe informatat për shfrytëzimin e kësaj vegle për kërkim të lehtë të shpenzimeve të funksionarëve të zgjedhur, ishin cituar në letrën e Zyrës e presidentit të Republikës së Maqedonisë, së bashku me ofertën për asistencë për shfrytëzim të Veglës, as nga Zyra, as nga presidenti Ivanov, deri tani nuk ka përgjigje nëse e pranon ose jo mundësinë e mënyrës së hapur dhe transparente t'u tregojë qytetarëve se si Zyra e presidentit të Republikës së Maqedonisë i shpenzon paratë e tyre", theksojnë nga pres shërbimi qeveritar.

ME BUXHETIN JEMI TRANSPARENT, PËRGJEGJËS DHE TË NDËRGJEGJSHËM

Kabineti i presidentit Gjorge Ivanov, në nëntë vitet e fundit, maksimalisht me përgjegjësi, me ndërgjegje dhe në mënyrë transparente disponon me mjetet buxhetore. Kjo theksohet në reagimin e Kabinetit të presidentit në lidhje me kumtesën e Qeverisë në të cilën potencohet se Ivanov nuk është përgjigjur në ftesën ta pranojë Veglën për llogaridhënie, me çka refuzon t'i informojë qytetarët për shpenzimet e tij zyrtare. Nga kabineti i Ivanovit potencojnë se të gjitha furnizimet publike nga ana e tyre janë kryer në mënyrë transparente maksimale dhe sipas të gjitha rregullave ligjore të njëjtat janë publikisht të arritshme. Këtë, siç potencojnë, e konfirmojnë edhe

raportet revizore për punën e Kabinetit të presidentit të zbatuara nga ana e Entit Shtetëror për Revizion. Me qëllim të informimit objektiv të opinionit, Kabineti i presidentit të Republikës së Maqedonisë, sikur edhe deri tani, ashtu edhe në të ardhmen, tërësisht qëndron në dispozicion për çfarëdo lloj informata të cilat kanë të bëjnë me punën financiare dhe shpenzimet e parave të popullit për nevoja zyrtare. Duke marrë parasysh se ekzistojnë mekanizma për kontroll të punës financiare të institucioneve shtetërore, Kabineti i presidentit nuk ka obligim ligjor të pranojë "vegla" shtesë, qëndron në reagim.

Bekteshi paralajmëron instalimin e 200 MWh të reja në vend

Vjenë, 22 qershor - Ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, ishte pjesëmarrës në Forumin ministror për energji të qëndrueshme, ku ministrat përgjegjës për energjinë nga Ballkani dhe vendet anëtare të Bashkimit Evropian, diskutuan për mënyrat dhe planet akcionale rreth rritjes së prodhimit të energjisë elektrike, përmes burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Qëllimi kryesor i takimit ka të bëjë me ruajtjen e ambientit jetësor, gjatë prodhimit të energjisë elektrike dhe planet që duhet të realizohen pas vitit 2020, në shtetet nënshkruese të themelimit të



Komunitetit Energjetik Evropian. Ministri Bekteshi në paraqitjen e tij tha se Maqedonia gjatë 12 muajve të fundit ka bërë reforma

në të gjitha fushat e energjisë, duke filluar me miratimin e Ligjit të ri për Energjetikë, plotësisht i koordinuar me Komunitetin

Energjetik Evropian, duke u ranguar në vendin më reformativ në kuadër të Komunitetit Energjetik. Me këtë rast, Bekteshi apeloj në in-

tensifikim të projekteve rajonale, për të arritur një stabilitet më të madh energjetik, duke pasur parasysh se i gjithë rajoni është i varur nga importi i energjisë elektrike.

Ndryshe, ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, është kryesues me Presidencën e Komunitetit Energjetik për vitin 2018, dhe në këtë cilësi do të merr pjesë në Takimin vjetor të ministrave përgjegjës për energjinë, industrinë dhe ekonominë, që do të zhvillohet në qytetin Wachau, në afërsi të Vjenës, me temë "Tranzicioni energjetik në vendet nënshkruese të Marrëveshjes për themelimin e Komunitetit Energjetik Evropian".

SHQIPTARËT SHUMË PAK E SHFRYTËZOJNË IPARDIN



POLLOGU E FUNDIT PËR TË HOLLAT EVROPIANE

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 22 qershor - Bujqit e rajonit të Pollogut kanë fituar më pak të holla nga programi IPARD 2, ndërsa përfituesit më të mëdhenj kanë qenë fermerët e rajonit të Pellagonisë, Vardarit, Juglindor, Verilindor dhe atij Jugperëndimor. Shkaqet kryesore për nivelin kaq të ulët të shfrytëzimit të fondeve bujqësore evropiane në Tetovë dhe Gostivar, ku gravitojnë dhjetëra fshatra, sipas përfaqësuesve të fermerëve, janë çështjet e pazgjidhura pronësore-juridike të tokës bujqësore dhe druajtja e bujqve të kësaj ane se sa me të vërtetë do të realizohen deri në fund marrëveshjet e nënshkuara.

"Në rajonin e Pollogut, jo se mungon interesimi i bujqve që të aplikojnë dhe fitojnë mjetet IPARD, megjithatë realizimin me sukses të këtij programi e pamundësojnë në radhë të parë problemet e pronësisë së tokës, ku shpesh një fermer punon më shumë se 15 hektarë tokë, ndërsa në pronësi të tij ka vetëm disa hektarë. Problem i dytë është frika e bujqve se realisht a do të fitojnë këto të holla, për shkak se ka ndodhur që bujqit në këtë rajon kanë nënshkruar kontratat e IPARD,

ndërsa në fund - edhe nuk i kanë fituar mjetet. Andaj, ne si organizatë që prezanton fermerët, propozojmë vendosjen e garancisë bankare nga ana e shtetit që të lehtësohet pagesa e këtyre mjeteve", thotë nënkryetari i Federatës së Fermerëve të Maqedonisë, Memet Sinani.

Në ndërkohë, përkundër rritjes së madhe në afër 700 shfrytëzues që të enjten filluan të nënshkruajnë kontratat për shfrytëzimin e IPARD 2, megjithatë para institucioneve përkatëse mbeten sfidat që edhe në thirrjet e ardhshme, të rritet numri i aplikuesve me qëllim që të tejkalohen shifrat modeste të shfrytëzimit të mjeteve të IPARD 1, ku nga mbi 3000 kërkesa në 12 thirrje, janë paguar vetëm 1000 kontrata apo afër 16 milionë euro.

Nga Agjencia për Përkrahje Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural apelojnë tek të gjithë fermerët që kanë nevojë të avancojnë veprimtarinë bujqësore, të aplikojnë në të ardhmen që të fitojnë mjetet e IPARD 2. Në këtë drejtim janë anuluar edhe mjaft pengesa si dhe janë thjeshtësuar edhe procedurat e nevojshme për aplikim.

"Nevojitet të punojmë të gjithë së bashku si Ministria e Bujqësisë,

MEMET SINANI

Në rajonin e Pollogut, jo se mungon interesimi i bujqve që të aplikojnë dhe fitojnë mjetet IPARD, megjithatë realizimin me sukses të këtij programi e pamundësojnë në radhë të parë problemet e pronësisë së tokës, ku shpesh një fermer punon më shumë se 15 hektarë tokë, ndërsa në pronësi të tij ka vetëm disa hektarë. Problem i dytë është frika e bujqve se realisht a do të fitojnë këto të holla, për shkak se ka ndodhur që bujqit në këtë rajon kanë nënshkruar kontratat e IPARD, ndërsa në fund - edhe nuk i kanë fituar mjetet. Andaj, ne si organizatë që prezanton fermerët, propozojmë vendosjen e garancisë bankare nga ana e shtetit që të lehtësohet pagesa e këtyre mjeteve

dhe institucionet e tjera me qëllim që edhe bujqit në rajonin e Pollogut të vijjnë deri tek këto mjetet", thotë drejtori i agjencisë, Nikollçe Babovski. Bujqit në Maqedoni nga IPARD 2, deri në vitin 2023 mund të sh-

Shkaqet kryesore për nivelin kaq të ulët të shfrytëzimit të fondeve bujqësore evropiane në Tetovë dhe Gostivar, ku gravitojnë dhjetëra fshatra, sipas përfaqësuesve të fermerëve, janë çështjet e pazgjidhura pronësore-juridike të tokës bujqësore dhe druajtja e bujqve të kësaj ane se sa me të vërtetë do të realizohen deri në fund marrëveshjet e nënshkuara



Procedura më të shpejta dhe kredibilitet ndërkomëtar të firmave

Shkup, 22 qershor - Lehtësim dhe përshtetshmëri të tregtisë, promovim të eksportit dhe të rritjes së përgjithshme ekonomike, si dhe rritje të kredibilitetit të firmave në suaza ndërkombëtare, duhet të mundësojë koncepti i Operatorit të Autorizuar Ekonomik (OAE). Siç u tha në promovimin e djeshëm, ky risi në punën doganore do të thotë përshtetshmëri të procedurave doganore dhe të lëvizjes së mallrave përtej kufijve në rajon. "Marrja e statusit Operatori i autorizuar ekonomik paraqet certifikim të shoqatës tregtare si partner i sigurt i Drejtorisë Doganore dhe partner i sigurt në zinxhirin rajonal dhe ndërkombëtar të furnizimit. Sapo të bëheni EAE, në bashkësinë ndërkombëtare do të jeni si partner biznes kredibil", theksoi zëvendësministria e Financave, Shiret Elezi.

Sipas drejtorit të Drejtorisë Doganore Gjoko Tanasoski, secili shtet tenton ta vendosë konceptin e OAE-së pse kjo nënkupton siguri të praktikave dhe përshtetshmëritë të tyre, si dhe garanci se mallrat do të mbërrijnë në vendin e caktuar në kohën e saktë të caktuar. "OAE është vlera e shtuar që e bën tregtinë ndërkombëtare më të shpejtë, më të sigurt dhe më efikase", nënvizoi Tanasoski.

VAZHDON QASJA SELEKTIVE E GJYQËSORIT

GJYKATAT JOTRANSPARENTË

Sipas analizës, është konstatuar edhe punë jotransparente e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në lidhje me shpjegimet e vendimeve të tyre. Koalicioni ka të bëjë edhe me të dhënat se ekziston praktika që gjykata nuk jep shpjegime përkatëse për shkaqet e parburgimit të caktuar

Shkup, 22 qershor - Shumë më shumë respektohen të drejtat themelore të qytetarëve në raport të gjykimit të drejtë dhe korrekt, por edhe më tutje duhet të punohet në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, tregon mbikëqyrja e Koalicionit "Të gjithë për gjykim të drejtë".

Siç u tha në promovimin e djeshëm të analizës më të re të "Koalicionit për vitin 2017", është e nevojshme transparencë më e madhe e procedurave gjyqësore si dhe transparencë më e madhe e

gjykatave. "Është detektuar shkelje në interpretimin dhe zbatimin e ligjeve nga gjykatat themelore dhe të apelit, argumentim i pamjaftueshëm dhe i paqartë i gjykimeve, si dhe qasja selektive gjatë veprimit të veçantë në lëndët të cilat kanë "notë politike". Qasja selektive nuk është mënjeluar edhe gjatë kryerjes së profesionit të prokurorit publik, ndërsa ndikimi politik është hasur edhe në vendimet për zgjedhje dhe përparim të kryetarëve të gjykatave dhe gjykatësve në gjykatat më të larta, qëndron në

analizën e monitorimit të zbatuar. Sipas analizës, është konstatuar edhe punë jotransparente e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në lidhje me shpjegimet e vendimeve të tyre. Koalicioni ka të bëjë edhe me të dhënat se ekziston praktika që gjykata nuk jep shpjegime përkatëse për shkaqet e parburgimit të caktuar.

Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë" ekziston 15 vite, ndërsa e përbëjnë 14 organizata qytetare. Vitet e kaluara monitorimi ishte



përqendruar në procedurat penale, por në kohën e fundit analizohen dhe krimi i organizuar dhe korrupsioni, përderisa nga shtatori do të fillojë ndjekja edhe e procedurave qytetare. Për përgatitjen e analizës ishin angazhuar 50 hulumtues të ndarë në katër rajone të apelit, në nëntë gjykata themelore të shtetit.

Vëmendje e veçantë, thuhet në Raportin e Koalicionit "Të gjithë për gjykim të drejtë", do të përkushtohet në projektin e ri që filloi ta implementojë Koalicioni "Qasje juridike, financiare dhe fizike deri

të drejtësia në gjykatat themelore në Republikën e Maqedonisë" i cili do të përfshijë analizë për implementim të drejtë të standardeve për gjykim korrekt dhe të drejtë, implikimet financiare për udhëheqje të procedurës gjyqësore qytetare, qasjen deri te drejtësia e kategorive të personave të marginalizuar, por edhe hulumtim me të cilin do të bëhet vlerësimi i qasjes fizike deri te drejtësia si arritje deri te ashensorët/barrierat interpretues të gjuhës me shenja dhe letër Braev për dokumentet gjyqësore. (O.Xh)

PROBLEMET ME KANALIZIMIN ATMOSFERIK NUK KANË FUND

RRUGA "172" SËRISH PROBLEM ME KANALIZIMIN

Kjo rrugë, sipas banorëve, është mjaft e stërngarkuar, sepse është arterie ndihmëse që lidh Tetovën me fshatrat e Komunës së Bogovinës. Në ndërkohë, nga Komuna e Tetovës theksojnë se është intervenuar dhe pritet që së shpejti të rregullohet tërësisht ky problem në këtë lagje



Koha Urim HASIPI

Tetovë, 22 qershor - Këtyre ditëve është intervenuar në rrugën "172" në Reçicë të Vogël nga ana e Sektorit për tokë ndërtimore në kanalizimin atmosferik, i cili nuk mund të grumbullonte ujërat, prandaj edhe kishte vërshime. Banorët disa herë janë ankuar edhe pse ishte intervenuar herën e parë, mirëpo problemet ishin shfaqur sërish kur ka patur reshje më të mëdha gjatë kësaj

periudhe. Sipas tyre, në këtë pjesë të qytetit problemi është se gypat që ishin vendosur një vit më parë, nuk mund të akumulojnë tërësisht ujërat dhe vjen deri tek havaria. Ata shprehen se uji që vërshon përmes rrugës po ashtu pengon edhe në qarkullimin e lirë të automjeteve që frekuentojnë gjatë ditës. Kjo rrugë, sipas tyre, është mjaft e stërngarkuar, sepse është arterie

ndihmëse që lidh Tetovën me fshatrat e Komunës së Bogovinës.

"Edhe pse ishte asfaltuar rruga, ishte rregulluar edhe kanalizimi, megjithatë situata në këtë lagje nuk është përmirësuar. Reshjet e shiut gjithmonë vërshojnë rrugën dhe një pjesë të bizneseve që ndodhen këtu. Kemi denoncuar si rast dhe presim të marrin masa që ky problem të zgjidhet njëherë

e përgjithmonë në lagjen tonë", janë ankuar banorë të kësaj lagje.

Në ndërkohë, nga Komuna e Tetovës theksojnë se është intervenuar dhe pritet që së shpejti të rregullohet tërësisht ky problem në këtë lagje. "Dëmtimi që ka ndodhur në rrugën '172' do të sanohet së shpejti, ekipet nga sektori ynë tashmë kanë dalë në terren për të evidentuar rastin dhe të shihet mënyra më e mirë për intervenim, në bashkëpunim edhe me NPK-në do të bëjmë edhe sanimin e gypave, të cilët janë të dëmtuar edhe pastaj do të bëhet rregullimi i kësaj pjese të rrugës", deklaruan nga Sektori për tokë ndërtimore pranë Komunës së Tetovës.

Por në këtë rrugë e cila vite me radhë ishte lënë pas dore dhe në mëshirë të fatit, sot edhe pse është asfaltuar, megjithatë problemet me kanalizimin janë duke e shkatërruar atë. Sipas banorëve, ka qenë një kanal i vogël që ka mbledhur ujërat sipërfaqësor kur ka patur reshje, por që është përdorur për edhe ujtitje. Sot, ai kanal është futur në gypa dhe është mbuluar për shkak të asfaltimit,

dhe ai gyp tashmë zihet shumë shpesh duke krijuar edhe vërshime të tjera në këtë pjesë të Tetovës, gjegjësisht në Reçicë të Vogël.

Problematike nga ana tjetër janë disa rrugë dhe lagje të Tetovës dhe rrethinës që vazhdimisht vërshohen nga kanalizimi në kohë kur ka reshje të shiut. Tashmë numri i shtëpive dhe ndërtesave dukshëm është shtuar dhe rrjeti i kanalizimit është i vogël për të absorbuar tërë ato ujëra që derdhen në këtë rrjet, prandaj edhe ndodhin vërshimet, sidomos në këtë periudhë kur reshjet e shiut janë shpeshtuar dukshëm. Krahas kësaj, po ashtu pritet të ketë intervenime edhe në pjesën tek tregu i gjelbërt në Tetovës, ku vite me radhë aty shkaktohet problem permanent gjatë reshjeve si pasojë e mos rregullimit të mirë të asfaltimit të rrethrotullimit dhe uji nuk të qarkullojë për në pjesën e poshtme të qytetit dhe grumbullohet në një vend.

Nga Komuna kohë më parë prematuan se do të merren masa, por ende punët në terren nuk kanë filluar për të eliminuar këtë problem që ndodh në pjesën qendrore të qytetit.

Publicitet

Në pajtim me nenin 84 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 124/15) Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, edhe krahas tentimeve të bëjë dorëzimin e rregullt të akteve administrative të sjella në procedurë administrative bën shpallje publike me:

LAJMËRIM

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ka sjellë akte administrative që nuk mund t'i dorëzojë personalisht edhe atë:

1. Lajmërim nr. 16-2251/1 nga 23.05.2018 për MHE KOZJAÇKA SHPKNJP, rr. Bul. 8-mi Septemvri nr. 4-1/21, Karposh, Shkup.
2. Vendim nr. 16-1521/1 vr. nr. 16-2832 nga 17.04.2018 për VADI KOMPANI SHPK EKSPORT-IMPORT STRUGË, rr. Marks Engelsova nr. 6/20, Strugë .
3. Lajmërim nr. 12-1-133/2 nga 14.03.2018 për VIZNAST SHPK, rr. Pande Ilkovski nr. 19, Manastir.
4. Lajmërim nr. 2017-69-0025891/2 nga 15.03.2018 për Tasevska Draga, rr. Stevo Filipovikj nr. 2/2-11, Shkup.
5. Vendim nr. 12-761/76 nga 23.03.2018 për Trpçevski Boris , f. Bazhdi, Strugë.
6. Vendim nr. 12-761/82/45 nga 30.03.2018 për Fermën e shpendëve GjDM 2017, rr. 22, nr. 52, Gazi Babë, Shkup.
7. Lajmërim nr. 2017-82-0045566/2 nga 10.04.2018 për Puravin SHPKNJP, f. Creshka, Shtip.
8. Lajmërim nr. 2016-78-0006169/3 nga 28.09.2017 për Miloshev Gjorgji, f. Çanaklija, nr. 80, Strumicë.
9. Lajmërim nr. 2017-55-0000469/4 nga 17.04.2018 për Zafirovski Dalibor, Nikolla Kirov Majski, Shkup .
10. Lajmërim nr. 2017-51-0001359/3 nga 17.04.2018 për Tashkovski Spase, f. Zhivojno, Novaci, Manastir.
11. Lajmërim nr. 2017-82-0000394/2 nga 26.04.2018 për Angellov Rade, f. Dugo Sello 49, Shtip .
12. Lajmërim nr. 2017-69-0000819/3 nga 05.02.2018 për Dimkoviq Cvetan, Bul. Partizanski odredi nr. 59/4-20, Shkup.
13. Lajmërim nr. 2017-80-0106398/4 nga 03.04.2018 për Eri Qufli, f. Reçica e Madhe, rr. 101 pn - Tetovë.
14. Lajmërim nr. 2017-82-0001471/2 nga 10.05.2018 për Ilov Trajçe, Balvan i Poshtëm, Karbinci, Shtip .

Ftohen personat e lartpërmendur në afat prej tetë (8) ditëve nga publikimi i këtij lajmërimi të paraqiten në lokalet e Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural - Shkup për marrje të vendimeve, ndërsa nëse nuk paraqiten, ky lajmërim me shpallje publike do të konsiderohet si dorëzim i rregullt në pajtim me nenin 87 paragrafi 2 i Ligjit për procedurë të rregullt administrative ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 38/05).

RRËNOHET OBJEKTI KONTESTUES

MERR FUND HALLI I BANORËVE TË "BLLOK 4"

Kjo lagje e re ndodhet në mes të fshatit Poroj dhe lagjes Drenovec në hyrje të Tetovës, ku në të kaluarën ka qenë e vendosur dhe ka funksionuar fabrika për prodhimin e Tullave. Banorët ishin ankuar se komuna nuk kishte marrë masa edhe përkundër premtimeve dhe vendimeve gjyqësore për rrënim



Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 21 qershor - Pas 12 vitesh pritje dhe kërkesa të panumërta drejtuar komunës, bëhet hapi i parë për hapjen e rrugës për banorët e "Bllok 4" në zonën tek ish fabrika e tullave në Tetovë. Është rrënuar objekti që ishte pengesë që të hapet rrugë më e mirë për të lëvizur këta banorë, të cilët deri më tash kanë shfrytëzuar një kalim alternativ që ishte shumë i vështirë. Pikërisht ky kalim alternativ ka qenë shkak që këta banorë edhe kanë dëmtuar automjetet e tyre. Banorët thonë se është bërë një hap i madh në të mirën e tyre. "Blloku 4 që quhet kjo lagje këtu, për 12 vite me radhë është lënë pas dore, ndoshta edhe nuk kanë pasur faj, nuk ka pasur edhe aq shumë

shtëpi, unë kam qenë i pari që kam ndërtuar shtëpinë në këtë bllok. Mirëpo, megjithatë kjo është një sukses shumë i madh pasi bëri një hap sa për të lëvizur në këtë rrugë. Është mirë që në të ardhmen, kushdo që bën projekte urbanistike, menjëherë të hapen rrugët tjera. Është një ndryshim i planit të bllokuar tonë që të zgjerohet akoma më shumë, që rruga e Ratajës që duhet të hapet edhe ajo rrugë, dhe jo vetëm këto 30 shtëpi, por edhe për 100 tjera bëhet edhe më mire", u shpreh Hajri Ismani, banor. Ai më tej nënvizoi se rrënimi i objektit jep mundësi të reja që të hapen rrugë të tjera që do të mundësonin edhe qarkullim më të lirshëm të banorëve jo vetëm të kësaj zone.

"Meqë projekti i planit detal urbanistik shkon shumë nëpër pro-

na private, e cila kushton shumë, ndërsa Rruga e Ratajës është e gatshme. Ne kemi biseduar edhe me zëvendësministrin e Mbrojtjes, ata janë të gatshëm dhe japin 15 metra prej lartë e deri poshtë rreth kazermës. Megjithatë, është bërë një hap i guximshëm nga ana e Komunës, sepse më herët kanë pasur frikë apo nuk kanë pasur guximin e duhur që të futen në planin detal urbanistik që vet e kanë bërë për të shmangur probleme të natyrave të ndryshme. Megjithatë, mendoj se tash Ligji ka filluar të funksionojë ashtu siç duhet", tha ai. Nga Sektori për tokë ndërtimore thonë se rrënimi ka filluar dhe pritet që ai vend të merr pamje tjetër. "Objekti që ndodhej tej ish fabrika e tullave ka filluar të rrënohet dhe kjo do të mundësojë lëvizjen e lirë të mbi

20 banorëve. Po ashtu në këtë vend planifikojmë të ketë gjelbërim dhe park për fëmijë, njëkohësisht edhe do të rregullohet rruga, sepse me të vërtetë ka qenë një pengesë e madhe", tha Arsim Nuredini nga Sektori për tokë ndërtimore. Përndryshe, para dy jave banorë të kësaj lagje kishin dalë në protesta duke kërkuar që komuna që të merr masa për të rrënuar këtë objekt, i cili ishte bërë pengesë kryesore për lëvizjen e tyre. Kjo lagje e re ndodhet në mes të fshatit Poroj dhe lagjes Drenovec në hyrje të Tetovës, ku në të kaluarën ka qenë e vendosur dhe ka funksionuar fabrika për prodhimin e Tullave. Banorët ishin ankuar se komuna nuk kishte marrë masa edhe përkundër premtimeve dhe vendimeve gjyqësore për rrënim.

Akuza të ndikuara nga politika

Gostivar, 22 qershor - Komuna e Gostivarit, jo vetëm bllok-dotacionet, por edhe mjete shtesë nga buxheti i saj u ka transferuar shkollave fillore dhe të mesme publike. Kështu përgjigjet Komuna e Gostivarit në lidhje me akuzat e drejtuara nga ana e drejtorëve të dhunshëm të shkollave fillore dhe të mesme publike të Gostivarit, se Taravari nuk i transferon nëpër shkollat mjetet financiare që sigurohen nga ana e shtetit. "Nga pranimi i detyrës së udhëheqësisë së re komunale e deri më sot, transferet nga pushteti qendror në emër të bllok dotacioneve për shkollat fillore dhe të mesme, Komunës së Gostivarit i janë transferuar gjithsej 275.930.033 denarë, ndërsa të dalat për këtë dedikim janë gjithsej 280.330.703 denarë. Kjo nënkupton se Komuna e Gostivarit, nga buxheti bazë, për shkollat fillore dhe të mesme ka ndarë 5.136.945 denarë, respektivisht mbi 84.000 euro. Rrjedhimisht, qëndrimet e shpalosura të drejtorëve të dhunshëm dhe skajshmërisht të politizuar, janë të pabaza dhe se fajin ata duhet ta kërkojnë tek vetvetja, ngase gjendja e krijuar është pasojë e paaftësisë së tyre dhe keqmenaxhimit, karakteristikë kjo që e përcjell subjektin politik që ata përfaqësojnë. Vlen të theksohet se përveç për shkollat, Komuna e Gostivarit ka ndarë edhe mjete të tjera nga buxheti bazë për çerdhet dhe dedikime tjera të cilat duhet të mbulohen nga bllok-dotacionet nga niveli qendror. Shuma totale e të cilave është rreth 7.000.000 denarë ose rreth 115.000 euro", përgjigjet Komuna e Gostivarit. (U.H)

KONFERENCË SHKENCORE NË UNIVERSITETIN E TETOVËS

Ferid Muradi tregon jetën studentore në UT

Tetovë, 22 qershor - Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave të zbatuara pranë Universitetit të Tetovës kanë organizuar një konferencë të përbashkët shkencore ndërkombëtare, të cilën e prezencën e tyre këtë konferencë e kishin nderuar edhe nobelisti i mirënjohur Ferid Murad, si dhe Bruno Ceka, kryetar i Komunitetit Shqiptar në Teksas të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Punimet e konferencës i shpalli të hapura rektori i Universitetit të Tetovës, Vullnet Ameti, i cili theksoi se që të gjithë në Universitetin e Tetovës ndjehen të nderuar me praninë e nobelistit Ferid Murad në Universitetin e Tetovës dhe pafundësisht



ndjehen krenar që emri i nobelistit Ferid Murad përfaqëson njërin nga dijetarët më të mëdhenj dhe më të respektuar në nivel botëror. Nobelisti me prejardhje shqip-

tare, Ferid Murad, me të pranishmit në këtë konferencë shkencore ka ndarë disa kujtime të jetës së tij studentore dhe projekte kërkimore shkencore, në të cilat ai ka

punuar. "Që në kolegji unë vendosa të studioja në një shkollë mjekësie, mirëpo në atë kohë - kuptova për një Ligj të ri i cili po zbatohet në Universitetin Cleveland. Ishte një program i cili kërkonte që studimet katërvjeçare të shndërroheshin në studime shtatëvjeçare, duke studiuar kështu në Bachelor, Master dhe doktoraturë njëkohësisht. Aty pata mundësinë të punoj me mentorin tim, i cili në atë kohë ishte drejtues i Sektorit për Farmakologji. Një vit para se unë të bëhesha pjesë e universitetit, mentorin im kishte zbuluar ciklin AMP në të cilën ai zbuloi se si disa hormone punojnë dhe ndihmojnë për të rregulluar metabolizimin në mëlçi. Punuam për shtatë vite rre-

sht në këtë subjekt dhe zbuluam se ishin shumë më shumë hormone që funksionin për të rregulluar sistemin fiziologjik dhe biologjik të njeriut", tha nobelisti Ferid Murad.

Për punimet dhe sesionet e Konferencës, para të pranishmëve folën dy dekanët e dy fakulteteve që janë edhe organizatore të konferencës, Fauzi Skenderi - dekan i Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore, si dhe Nderim Zeqiri - dekan i Fakultetit të Shkencave të zbatuara. Përndryshe, kjo konferencë punimet e saj do t'i zhvilloj sot dhe nesër, ku studiues eminent nga vendi rajoni dhe bota do të prezantojnë studimet e tyre. (U.H)

Sheh rrushi rrushin... (e Shqipërisë) dhe prishet!



Nga
Daut DAUTI

Akeni dëgjuar për rregullën gramatikore “kështu e bëjnë në Shqipëri”? Sigurisht nuk keni dëgjuar, por ndoshta pa vetëdije jeni bërë rob të saj!

Së pari, t'ua tregoj lexuesve një anekdotë për një të krishterë që kishte dashur të bëhet mysliman. Hoxha ia kishte bërë duanë dhe e kishte mësuar si të falet. Kur kishte parë se e ka pak si vështirë ta kuptonte sa herë duhej të bie në sexhde e të çohet në këmbë, hoxha i kishte dhënë një këshillë praktike: Bën si bëjnë të tjerët. Ditën e parë të faljes në xhami, myslimani i ri e kishte mbajtur mend këshillën e hoxhës, çou, ulu, çou, ulu...si të tjerët. I përkushtuar deri në maksimum, koncentrohet që t'i përmbahet këshillës së hoxhës. Mirëpo, në radhën pas tij kishte ndodhur një burrë që e kishte pasë vënë “kamishin” në shpinë nën lurkë. Kur kishte rënë në sexhde, kamishi i zgjatur përtej kokës, e prek myslimanin e ri në prapnicë dhe ky kishte kujtuar se kjo është pjesë e ritualit, prandaj edhe ai e prekë me gisht atë para tij në të njëjtin vend. Mirëpo, ky myslimani tjetër, i befusuar nga kjo prekje ku s'e ka vendin, t'i kthehet myslimanit të ri dhe ia “zhaveshë” një shuplakë të nxehtë sa t'i shohë yzjit, por ai nuk befusohet, në çast kujton se edhe shuplaka qenka pjesë e ritualit të namazit, dhe i kthehet atij pas tij, “pronarit” të kamishit, dhe t'ia ngjeshë shuplakën...

Duket njësoj si kjo mesele kur sheh se si shqiptohen ose shkruhen emrat e huaj gjithandej duke u shndërruar në epidemi të vërtetë,

që ka infektuar gjithë hapësirën mediale shqiptare. Si një ortek i rrezikshëm bore, s'ka fuqi ta ndalë askush, edhe pse gjuhëtarë të ndryshëm kanë tërhequr vërejtjen, por kanë hasur në veshë të shurdhër. Këto ditë e pata një postim në facebook, me “vërejtje dhe këshilla publike” kolegëve nga TVM-ja të cilët komentoni ndeshjet nga Kampionati Botëror në Futboll Rusia 2018, duke u vënë në dukje shqiptimin e gabuar të emrave të futbollistëve, të cilët sipas shembullit të Shqipërisë, nuk i lakojnë fare, ose herë i lakojnë, e herë jo. Por, do të isha i padrejtë që problemin ta loçoj vetëm te gazetaret e sportit dhe vetëm në TVM, sepse, siç cekta më sipër, ky trend është bërë tashmë dukuri masovike, dhe stacionet televizive të Kosovës dhe Maqedonisë, janë bërë viktimë e kopimit të kësaj praktike të gabuar. Për ilustrim se si tingëllojnë panatyrshëm veçova jo pak shembuj. Që të mos ma zënë për të madhe këta të sportit, do ta marrë fillimisht shembullin e një gazetari të ri të TV Alsatit, i cili duke lajmëruar prej para Kuvendit, në një moment i drejtohet auditorit: “tash ta dëgjojmë deklaratën e Tuntev”! Po ky djalosh që ka filluar të merret me gazetari, a ka mësuar në shkollë gjuhë amtare dhe a ka dëgjuar për lakimin e emrave në rrasa, a e di çka është rrasa emërore, gjinore, kallëzore, dhano-re, rrjedhore dhe përse shërbejnë ato? Ose, çfarë të thuash për titullin e portalit ose gazetes kësajsoj: “Kërcënimet e Vuçiqit se do t'i braktisë bisedimet” ose “Angela Merkel u takua me Makron”(tingëllon si makro!) Meqë këto ditë po përcjellim

botërorin në futboll, e kemi vështirë të gjejmë televizion ose komentues i cili i shquan ose i lakon emrat e futbollistëve. Parapëlqej të dëgjoj komentim kroatist ose maqedonist, sepse ata i respektojnë rregullat e gjuhës së tyre. Si ju duken shembujt si vijon: “Skuadra e Petkoviç”(në vend se “Skuadra e Petkoviçit”, “së bashku me Neimar”(në vend se “së bashku me Neimarin”), “topi për Seferoviç”(në vend se “topi për Seferoviçin”, “pa problem për Jan Somer”(në vend se “...për Jan Somerin”) “topi për Zuber”(në vend se “për Zuberin”), “me golin e Kolarov”(në vend se “me golin e Kolarovit”, “topi për Lustig”, (në vend se “...për Lustigun”, “ka luajtur për ekipin e Daevu”(në vend se “...për ekipin e Daevusë”, edhe pse i njëjti komentues në një rast tjetër shqipton drejt “Lojtari i Tokios”, që është e njëjta rasë lakimi!), “Edhe një tjetër mundësi për Berg”(në vend se “edhe një tjetër mundësi për Bergun”, “faul ndaj Rakitiç”(në vend se “faul ndaj Rakitiçit) etj. Ja dhe disa shembuj të tjerë që i kisha veçuar më herët, ku shpesh kemi edhe jokonsekuencë në të njëjtën praktikë: Në një moment, raportuesi thotë “...skuadrës së Anderlehtit”(trajtë e drejtë), por pak më vonë “Skuadrës së Manchester Junajted”(shtrembër) ose “...të skuadrës së Anderleht”(shtrembër), “luan me Mikhytarian”(shtrembër), “ndërrhyrje e Obradoviç”(shtrembër); “Karton i verdhë për Iva”(shtrembër) dhe përsëri raportuesi i njëjtë “harrohet” për pak dhe drejtë shqipton “Skuadra e Manchester Junajtedit”, por pastaj vazhdon “Nga ana e Mykita-


Ka një fjalë popullore që thotë se “nuk është ar gjithçka që shkëlqen”, ndaj dhe është naive të përqafosh “modele” gjuhësore vetëm pse vijnë nga Shqipëria. Motivi për t'i ruajtur emrat e huaj në origjinal, nuk përkon me rregullat e gjuhës shqipe



rian”(gabim) “...e Antonio Marsial”(gabim), “top i Zllatan Ibrahimoviç për Pogba”(gabim), “gjuajtje e Ani”(gabim), “një gjuajtje e shkëlqyer për Manchester Junajted”(gabim), “Pozicion jashtë loje të Antonio Marsial”(gabim). “Barazon skuadra e Anderleht”(gabim, por pak më vonë: “skuadra e Anderlehtit”, drejtë!), “Zhoze Murinjo i zgjënjer me Fellainin”(drejtë) dhe në fund prapë margaritar: “Përfundon baraz dueli midis Anderleht dhe Manchester Junajted”. Pastaj komentuesit në studio, kush si mundet flasin shqip dhe “shqip”: “...Skuadra e Genk”, “Ndeshja midis Anderlehtit dhe Manchester Junajtedit”, “...është shumë larg nga sulmuesi i Manchester Junajted”, “Portieri i skuadrës së Genk”, “Fitoi në ndeshjen e parë ndaj Gent”.

Pyetja është më se thelbësore: në bazë të cilave rregulla të gjuhës shqipe emrat e huaj përjashtohen nga shquarja ose lakimi në rrasa? Përgjigja: “kështu bëjnë në Shqipëri”! Por, “kështu bëjnë në Shqipëri” nuk është rregull, por një praktikë e mbrapshtë kushedi si ka nisur pas rënies së komunizmit(sepse këso shkeljesh më parë nuk ka pasur). Më kujtohet një emision i Arian Çanit(Zonë e lirë, TV Klan), ku intelektual i njohur, Edmond Tupja, duke dëgjuar se si nuk lakoheshin emrat e huaj, u mundua të shpjegojë se edhe emrat e huaj iu nënshtruan rregullave të gjuhës shqipe. Edhe gjuhëtarë të tjerë nga Tirana kohë pas kohe e kanë ngritur zërin, por kjo assesi nuk ka ndikuar që t'i ndalet hovi kësaj dhe disa praktika-ve të tjera që përhapen si sëmundje ngjitëse!

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: “Adria Media Balkan” - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 Kocje | Data e shtypjes e premtë 22 qershor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Motivi për t'i ruajtur emrat e huaj në origjinal, nuk përkon natyrën e gjuhës shqipe. Bie fjala, sa "bukur" e "shqip" tingëllon të thuash "Bush u takua me Putin"! Për ironi para disa vitesh duke e përcjellë këtë "trend", kisha parashikuar se së shpejti edhe emrat shqiptarë nuk do të shquhen ose lakohen nëpër rasa dhe për fat të keq, gjithnjë e më tepër në gazeta, portale e sidomos në televizione, ka hyrë edhe kjo çoroditje (këtë term e parapëlqej, sepse nuk di si ta quaj ndryshe). Ja, gjykoni ju, vetëm dy "margaritarë" nga moderatori i njohur Alban Dudushi, i cili në një emision (19 prill 2017), paralajmëroi mysafirë kështu: "...Dhe ftoj Adelina Berisha" (në vend se "ftoj Adelina Berishën") (1) dhe "ftoj në studio Shkëlqim Xika dhe Enver Hoxha..." (2), (në vend se "...Shkëlqim Xikën dhe Enver Hoxhën").

Nuk ka nevojë ta dish gramatikën në mënyrë të përpiktë për të përdorur emrat sipas kontekstit adekuat, mjafton të flasësh shqip. Këto forma të çoroditura që i shkelin rregullat e gjuhës shqipe, po depërtojnë këndej kufirit, nga pakujdesia ose nga bindja naive se gjithçka që vjen nga Shqipëria duhet të jetë gjuhësisht korrekte. E vërteta është se nga Shqipëria na vjen sintaksa më korrekte se këndej, por ndikimi i gjuhëve të huaja, përplot SURPRIZA, EVENTE, EVENEMENTE, REFRAKTARE, VAKANTE...bën që të harrojmë që për to kemi fjalë të pastra shqipe! Ose mbaresat e mbiemrave sillavë të ish-Jugosllavisë, të cilat më parë i shkruanim me IQ, tash, sipas shembullit të Shqipërisë, vetëm me IÇ. Të paktën ne që kemi jetuar në ish-jugosllavi nuk duhet t'i gabojmë, duke e ditur se ato mbiemra në orgjinal përfundojnë me shkronjën "Ć" (Q) e jo me "Č" (Ç). Ose shprehje tipike jugore (vënd, kuvënd, dhëmb (për kuvënd), etj) si letrare...

Nga Shqipëria, ne këtej kufirit, kemi pasur mësuesit e parë, për çka i falënderojmë, se na e kanë mbjellë dijen, kulturën dhe kanë qenë shembull edhe për pastërtinë e gjuhës. Ka një fjalë popullore që thotë se "nuk është ar gjithçka që shkëlqen", ndaj dhe është naive të përqafosh "modele" gjuhësore vetëm pse vijnë nga Shqipëria. Në këtë temë mjafton të shikohet se si bie fjala në kroatisht ose serbisht lakohen emrat e huaj (ato kanë rasa lakimi ngjashëm si shqipja "padeži"), ndërkaq gazetarët dhe intelektualët tanë, kanë hyrë në terrenin e maqedonishtes e cila ka rregullat të tjera nga shqipja (shembull: "topi për Seferoviq" (топка за Сеферовиќ)!

Nuk ka thënë kot populli "Sheh rrushi rrushin dhe piqet", por dhe "Sheh rrushi rrushin dhe prishet"!

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

TREGU I VOTËS

Ky titull me tone të forta li-ri-ke është sa utopik aq edhe acarues për një pjesë të madhe të njerëzve! Me "sikur" fillojnë një tufë fjalish të cilat tregojnë veprime të përfunduar të cilat kanë sjellë pasoja të liga dhe të pësuarit qajnë mbi fatin e tyre të mbrapshtë duke thënë: ah sikur të kisha vepruar ndryshe... Pra, pavarësisht se ka me dhjetëra forma për të përdorur fjalën "sikur", në pjesën më të madhe të rasteve kjo fjalë përdoret për të shprehur pendesë për aksione të parealizuar...

Dhe banorët e këtij vendi, ka shumë "sikurse" që janë kthyer në "kusure"... Shumë parti që nuk marrim rezultatin e prititur në zgjedhje, nxitojnë menjëherë të bëjnë denoncimin e vjedhjes së votës. Kjo tashmë duket gati klishe. Madje ka syresh që thonë se pretendimi i manipulimit të votës është thjesht një justifikim i dalë mode për të mbuluar dështimin e partive humbëse. Por që votat manipulohen e dinë më mirë jo partitë që dalin me rezultate të ulta në krahasim me pritshmëritë e tyre, aspak, mbi të gjitha e dinë partitë drejtuese!

Është njëra nga këto parti që vazhdon të trashëgojë një nga mekanizmat më kriminalë të deformimit të votës. Sigurisht që nuk janë të gjithë individët e kësaj partie sekserë e bixhozçinj të tregut të votës, por fatkeqësisht një

pjesë ku përfshihen faktorë drejtues të saj, janë! Mirëpo në pazarin e fëlliqur të shitjes së votës, që shumë drejt do t'a parafrzoj dhe si pazari i fëlliqur i fëmijëve, pasi duke shitur votën nuk ke shitur veten por ke hedhur në duar të pista të ardhmen e fëmijëve, në këtë pazar pra, natyrisht që ka dhe kërkesë andaj ka dhe ofertë. Asnjë treg nuk funksionon pa këtë binom.

Domethënë ka shkallë të ndryshme të atyre që pranojnë të shesin vota. Shumica janë të ndershëm, e shesin votën për një vend pune të dikujt në familje, kurse ka një kategori e cila është më e vogël, por që unë e quaj Kategori e Rëndë! Këta nuk shesin, këta e vjedhin votën me të madhe! Po! Kryesisht aradhet e këtyre lloj bandave përbëhet nga njerëz të pashkollë, të rritur keq, që sigurojnë përmbysje dramatike rezultatesh. Shatisin dynjanë me rokada rezultati të pabesueshme që ndodhin kryesisht minutat e fundit të numërimit të votave.

Zgjedhjet kokale nuk kanë shumë që kaluan, tregu ishte aktiv, në fakt tregu nuk pushon asnjëherë, por në kohën e zgjedhjeve bëhet më i dukshëm, tregtarët e votës s'kanë shumë kohë që po shohin rezultatet. Kështu një pjesë e mirë e atyre të shkretëve që bën fushatë në çdo derë motre, vëllai, djali e vajza axhe, në çdo derë të fshatit, me parullën: votoni Filanin se na ka premtuar se do na fusë në punë 5 nga ne, tashmë të gjithë

Vet politikanët që e kanë blerë rezultatin e kanë situatën jashtë kontrollit. Ndjehen të shantazhuar nga disa kolegët e tyre të biznesit! Nuk mund të thonë JO se njëherë të bashkëpunosh me krimin, bëhesh pjesë e tij, ndaj dhe këta politikanë kanë arritur në pikën e fjalisë: Ah sikur të kisha vepruar ndryshe...



janë po aty ku ishin...ju është thënë të presin nga Premtuesit, pavarësisht se ata kanë shkelur çdo cm dinjitet të tyrin duke shkuar e ly-pur vota në dyer fisi apo fshati apo lagjeje, ata sërish duhet të presin...vendet e punës ende nuk po vijnë, çdo ditë pritje është e barbartë me një ditë zhgënjimi, turpi, ndjehen të tradhtuar, në mendjet e tyre po qarkullon gjithnjë e më shumë fjalja: sikur të kisha vepruar ndryshe... Nga ana tjetër bosët e politikës sa vjen dhe po kapen nga tipi i rëndë i tregtarëve prandaj nuk kanë vende pune bosh! Në një pjesë të posteve të drejtorëve, në krye

të sektorëve, janë të pozicionuar përfaqësuesit e atyre që sigurojnë vota me të madhe.

Vet politikanët që e kanë blerë rezultatin e kanë situatën jashtë kontrollit. Ndjehen të shantazhuar nga disa kolegët e tyre të biznesit! Nuk mund të thonë JO se njëherë të bashkëpunosh me krimin, bëhesh pjesë e tij, ndaj dhe këta politikanë kanë arritur në pikën e fjalisë: Ah sikur të kisha vepruar ndryshe... Gjumi për ta është bërë luks i pakapshëm, në rastin më të mirë pinë nga një grusht barnash, në rastet më të zakonshme janë peng i drogës dhe i alkoolit...toka po ju dridhet në këmbë! Ky është një film aspak i mërzi-tshëm, është një film i dhimbshëm!

Koha po vepron dhe Pazari i Votës po shuhet, por ende ka qytetarë që duan të gënjejnë! Sa keq, sa trishtueshëm, sa gjynah për fëmijët e tyre!

Kështu do vazhdoni të komandoheni nga komshiu juaj që e la shkollën në moshën 9-vjeçare...nëse do keni fatin që ai të tregohet zemërmadh dhe t'ju fus në punë, ndryshe do kënaqeni vetëm me ndonjë përsëritje të komshiu-t të fortë që është bërë drejtor, shef, bos, mafioz...në disa raste nuk ka dallim! Por këto janë pasojat e tregut të votës, këto janë SIKURSE të kthyer në KUSURE!

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

Padrejtësi normale

Siç e parashikoja, shoferi im erdhi 40 minuta me vonesë. Jeton në Jerusalem, kështu që nuk e dinte se rrugët e Ramallahut, mbrëmjeve të Ramazanit mbushen me makina dhe njerëz që vijnë nga gjithë fshatrat e zonës. Vetëm një palestinez nga Jerusalem mund të më shoqërojë në aeroportin e qytetit. "Ata në Cisjordani mendojnë se jemi me fat, sepse kemi një dokument identiteti nga komuna e Jerusalem", më tha shoferi, që është 24 vjeç. Ndërkohë i tregoja rrugën që duhej të përshkonte, përmes fshatrave që as nuk dinte se ekzistonin.

Kjo gjë më bëri shumë përshtypje: fragmentimi i Cisjordanisë është tashmë kaq i madh, sa që në mendjen e tyre palestinezët nuk njohin më as vende që janë vetëm



20 kilometra larg nga shtëpia. Djali më pyeti sa e paguaj qeranë. "Po të paguaja kaq pak, do isha martuar tani". Ai jeton ende me prindërit. "Por, nëse do të transferohesha në Ramallah, do të humbisja statusin e banorit të Jerusalem".

Ndërkohë që një izraelit që shkon të jetojë në një koloni, i ruan të gjitha të drejtat. Është kaq e padrejtë". Isha dakord me të.

Në rrugën e hyrjes në aeroport, një agjente sigurie etiopiane na kërkoi t'i dorëzojmë dokumentet

dhe të presim. Donte të dinte si e kisha njohur shoferin dhe nëse ishim të afërm. Kontrollloi bagazhin. Ai u hoq mënjane për ta kontrolluar. Isha shumë e zemëruar. Por në fund, ai më tha: "Mos u mërzi-t, është normale". (Internazionale)

Nga Amira HASS



shtojcë enigmatike e fundjavës


FJALËKRYQI KLASIK

HORIZONTALISHT

3. Aktori amerikan, Kristofer (Supermen)
5. Armë e rëndë zjarri
7. Dritare
10. Ka i egër i Amerikës Veriore
12. I fëlliqur, i papastër në trup
13. Vend me ujë të ndenjtur, ligatë
15. Frikë e madhe
16. Shenjë
18. Për (lat.)
20. Peshku i madh i ujërave të ëmbla
23. Lloj pete me shtresa
24. Tërësi njerëzish të një gjaku
28. Lëvizje e shpejtë, vrull
29. Menjëherë (krahin.)
30. "I biri i" (arab.)
31. Era e rëndë (bised.)
33. Ai që merr pjesë në një bisedë
41. Që ka të bëjë me bankën
42. Një muaj viti
43. Ish tenisti francez, Janik
44. Rajon afër Prizrenit
47. Këndez
48. Jo urban
49. Ish politikani turk, Ismet

VERTIKALISHT

1. Nisje
2. Mashkull i rosës
3. Skllav
4. Enë për lule
5. Pjesa e butë e bukës
6. Lezet
8. Llambë elektrike
9. Aktori amerikan, Hauard
11. Politikani shqiptar, Fatos
12. Qengj i butë
14. Litiumi
15. Organizatë politike
17. Institucion i arsimit fillestar
18. Shenja e mbledhjes së numrave
19. Këngëtarja jonë, Ora
21. Erë e lehtë freskuese
22. Poen në karate
23. Bashkëtingëllore të njëjta
24. Mal midis Shqipërisë dhe Maq.
25. Katër (romak)
30. Manifestim dyvjetor
33. Diplomati korean, Ki Mun
34. Marr anën, prirem
35. Shoqëria Kulturore Artistike
36. Posedon
37. Bashkëtingëllore e zanore
38. Vëllai i babait ose i nënës
39. Më merr etja
40. Çelësi muzikor
45. Veprimtari
46. Autori ynë, Vreto.



Kakuro

e lehtë

		16	30			
	16				4	3
	15			3		
				11		
	4	16				
22						3
12			3			
			4			

mesatare

		23	6			3	17
	11					9	
					7		
	9			12			
				6			
	14					24	7
				14			
	3	16					
	12					10	
	9					12	

e vështirë

		17	4			34	3	
	9					11		
					35			
	27							
				15				
				11				
			3				3	16
		23						
	9					10		



FSHEHËSIRA

Zbuloni figurat e fshehura!




FIGERMA (lexoni me objekte)

Rusia 2018

Figurat gjeometrike përfaqësojnë shkronja. Zëvendësoni ato dhe do të gjeni pesë shtete pjesëmarrëse në Kupën Botërore, Rusia 2018!

Figurat paraqesin shkronja, varësisht nga forma e tyre. Psh. te rrathët do t'i shënoni zanoret.



- a, e, o, u, y
- ë, i
- c, ç, m, n, r, s, v, x, z
- rr
- b, d, f, h, k, l, t
- dh, ll, sh, th, xh, zh
- gj, nj
- g, j, p, q

Ndihmë: Janë përdorur 15 shkronja të ndryshme, prej të cilëve 3 janë zanore.

DEKODIMI

Fjala e kërkuar fillon nga katrori i vogël dhe përfundon te rrethi.

Duhet të zgjidhni njëren nga katër shkronjat në secilën fushë dhe të vazhdoni në fushën tjetër.

Në fund, lexuar me radhë fitohet zgjidhja e kërkuar, e cilaka të bëjë me Kupën Botërore, Rusia 2018.

ABCC	DDHEË	FGGJH
IJKL	LLMNNI	OPQR
RRSST	THUVX	XHYZZH

Zgjidhja:

5 dallime




Mini KENKEN

Në kutizat e dhëna shënohen vetëm numrat 1, 2 dhe 3. Ashtu si te sudoku edhe këtu në çdo rresht dhe kolonë nuk guxon të ketë numra të njëjtë. Numrat në skajet e sipërme të katrorëve e tregojnë rezultatin, ndërsa shenjat pranë tyre, operacionin matematikor që duhet ta përdorni për të arritur deri te rezultati.

1 -	8 +	
		1 -
3 x		


SUDOKU "më i madh se"

Përdoren numrat prej 1 deri 9.
Vlejnë rregullat e sudokut.
Shenja ">" paraqet relacionin
"është më i madh se".



KENKEN

Përdoren numrat prej 1 deri 6.
Vlejnë rregullat e sudokut.
Numrat tregojnë rezultatin,
ndërsa shenjat pranë numrit,
operacionin matematikor.




ARUKONE (Çiftimi)

Bashkoni me vija numrat e njëjtë
(çiftet). Vijat nuk guxojnë të priten.
Duhet të përfshihen të gjitha
fushat!




NONOGRAMI

Nxini fushat sipas numrave
të dhëna. Numrat e dhëna
e tregojnë numrin e fushave
që duhet të nxihen.





ARITMOGRIFI - fjala e urtë

Përgjigjet i shënori në rrethin me numra (majtas), pastaj, sipas rregullit
"numri i njëjtë - shkronja e njëjtë", shkronjat e fituara bartni në tabelë
(poshtë)! Do të fitoni një fjalë të urtë.




Zyra e një partie politike
Merak
Pjella e pelës
Mënjanon
Boletini
Mjekime



Përgjigjet përbëhen nga këto rrokje:

A, DË, E, GE, I, LI, LI, ME, MË, MI, NON, RË, RË, RI, SE, SË, SHË, SHI, XHI, ZI

NUMËRKRYQI



Horizontalisht

1. Numri i ndeshjeve të Ronaldos në fanelën e Portugalisë, deri në Kupën Botërore 2018
3. Numri i pjesëmarrësve në Lojrat e Para Olimpike, Athinë 1896
5. Një nga shtigjet (disiplinat) në kanu, në metra
6. Numri i ndeshjeve të Stiv Bulit në fanelën e Vulverhemptonit
8. Anagram i **1 horiz.**
10. Numri i ndeshjeve të Ozilit për Real M.
12. Anagram i **9 vertikal.**
14. Brazili është i ranguar i pari në botë në futboll, me sa pikë?
15. Palindrom i **6 horiz.**
16. Palindrom i **3 horiz.**

Vertikalisht

1. Numri i ndeshjeve të Brazilit në kupat botërore, deri në Rusi 2018
2. Italia është e ranguar e treta në botë në futboll, me sa pikë?
3. Numri i shteteve pjesëmarrëse në LOV Rio 2016
4. Numri i përgjithshëm i medaljeve të Kinës në Lojërat Olimpikë Verore.
7. Rokada e madhe në Shah
9. Numri i golave të shënuar në Kupën Botërore, Brazili 2014
10. Rekordi i golave në La Liga i Barcelona, në sezonin 2016/2017
11. Shuma dhe dy mbledhësit
12. Numri i ndeshjeve të Dondinjos (babait të Pelesë)
13. Prognoza sportive

MOZAIKU Futboll

4 shkronja

DIDI, EVRA, LATO, MALI, MARK, NANT, PEPE, RAUL, ROMA

5 shkronja

ANITA, BLEJN, NASRI, SFIDA, SKOLS, SPANJA

6 shkronja

ASTANA, BARTRA, DAGLAS, EGJIPTI, FINALE, FRANCA, FUTBOLL, KEMPES, LARISA, PANAMA, RAMOSI, STOPER, TIGANA

7 shkronja


MEKSIKA, ORLANDO, RUMANIA, TUNIZIA.



Zgjidhja:



Pasi t'ua gjeni vendet fjalëve që kanë të bëjnë me futbollin, në fushat e rrethuara do ta fitoni kampionin e fundit botëror, në Brazil 2014.



Sudoku

i lehtë

		7	9		6	4		
8	3				1			
			6		3			
4		3	8					7
	8				4			
1		2		6				8
		9		1				
	1					5	3	
2	5	9	3					

mesatar

		3				8		
	9		3		5		1	4
	2		8	9				
9				5		6		
	8	6					3	
2								7
						7	6	
7			5	6		1	9	
					1			2

i vështirë

		4					6	1
			1		3			
	6		4	5	7			
				6				8
	6	5						7
8	1		7					
	1			9				
			3	7			5	2
5	8				4			

SKANDI I KOMBINUAR

Shkronjat e pjesës së hijezuar të fjalëkryqit bartni në tabelë. Me ato shkronja do t'i fitoni zgjidhjet e **anagramit** dhe **rebusit**, që kanë të bëjnë me futbollistin më të mirë shqiptar, të cilin e përcollëm këtyre ditëve.



Anagrami sinonim

7	8	5	2	10	6	12	9	1	11	9	4	2	5	2	3	8	7	2
---	---	---	---	----	---	----	---	---	----	---	---	---	---	---	---	---	---	---

TABELA

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
---	---	---	---	---	---	---	---	---	----	----	----

Rebusi

3	11	7	2	4	8	9	5	2	10	8	6	7	2	1	2	9	5	12
---	----	---	---	---	---	---	---	---	----	---	---	---	---	---	---	---	---	----

MENSUR MAMUTI	SËMUNDJE, ÇRRREGULLIM I SISTEMIT NERVOR QENDOR	KOCKË ZAR (LAT)	NJËSIA E VËLLIMIT TË LËNGJEVE (SH. PASHQ.)	TRANSMETIM TELEVIZIV	LUMË NË FRANCË	FATKEQËSI E MADHE	HËNA E JUPITERIT	AZOTI	AKTIVISTA PRESHEVARE, SADIKU	PERËNDIA GREKE E QIELLËT DHE TOKES	REGJISORJI YNE, KRYEZIU (SHQ.)	TANTALI
BANORËT E PALESTINËS												
ZOGU I VIZATIMOREVE												
K								ALEKSANDRI				
RRJETËZA E SYRIT							KOMUNË NË FRANCË					DREJTUES I TIMONT
BANORËT E KARTAGJENËS					1	2						
ITALIA	PËREMËR VETOR				2	3		2	PËREMËR PRONOR			
	ARMË E RËNDË ZJARRI								EMËRTIME			
NITONI			FATKEQËSIA, MËRIMI	4	2	5	2	6	2		ILIR META	
			AKTORE AMERIKANE								PËREMËR PRONOR	
SYSTEMS ORIENTED DESIGN			5		7	8	9		4	8		OKSIGJENI
												ARI
NJËRI NGA KATER KALIFET			2	10	8		5	2	10	4		
AZOTI		FSHATAFËR GOSTIVARIT		8	10	5	8	4	11		POHIM FRËNG	
		SHKRIMTARI ÇEK, ÇAPEK									QË I SHMANGET PUNËS, HILEQARI	
KOHA E LIRË	KËRÇOVA			Ë I	12	8		11		ANGSTREMI		ENERGJIA
	LËNDA E SHKRIRË E VULLKANIT			A						AMERICIUMI		AKTORJA FRËNGJE EME
DEVE AUSTRALIANE					NATRIUMI	9	11		QYTET NË IRAN			
					LIRA ITALIANE				AKTORI PAÇINO			
GRUP LUDHESHASH NË GUINE TË RE					LAROSH							NATRIUMI
					TENESINA							
PINGUL										AKTORI KOSOVAR, LAUÇI		
									TH			
KIK-BOKSIERI HOLANDEZ, OVEREM										VEGËL PËR TË PRERË		

Grids for various puzzles: Sudoku, Nonogram, Arukone, Kenken, and Kakuro.

SUDOKU

Grid with numbers and letters for solving.

NONOGRAMI

Grid with numbers for a picture puzzle.

ARUKONE

Grid with numbers for a logic puzzle.

KENKEN

Grid with numbers for a math puzzle.

SUDOKU "S"

Grid with numbers and letters for a special Sudoku.

KAKURO

Grid with numbers for a crossword-style puzzle.

DALLIMET

Illustration of a bird.

DEKODIMI

Diagram for a code puzzle.

FIGURMA (lexoni me objekte)

Illustration of a group of people.

NUMERKRYQI

Grid with numbers for a crossword puzzle.

MINI KENKEN

Small Kenken puzzle.

Zgjidhjet

Answers to the puzzles.

MOZAIKU Futboll

Stylized soccer ball mosaic.

PLATËKRYQI KLASIK

Classical crossword puzzle.

“SHQIPËRIA MUND TË MBAJË ANGELA MERKELIN NË PUSHTET”

Duke hapur qendrat e pritjes Shqipëria do të fitojë mbështetje edhe nga forcat më konservatore të bllokut që janë skeptike për fillimin e bisedimeve të anëtarësimit. Pyetur nga BIRN, një zyrtar i Këshillit të Europës iu përgjigj me 'jo' pyetjes nëse ka apo jo një plan për bazë dizbarkimi refugjatësh në Shqipëri dhe mohoi gjithashtu që një plan i tillë të jetë kusht për hapjen e negociatave për anëtarësim

“Shqipëria mund të mbajë Angela Merkelin në pushtet”. Nën këtë titull, gjermania “Deutsche Welle” shkruan se Shqipëria mund të shërbejë si një vend pritës i përkohshëm për azilkërkuesit që i drejtohen Bashkimit Evropian. Një zëdhënës i qeverisë austriake thotë për Deutsche Welle se bisedime për qendra të tilla kanë nisur me Shqipërinë dhe me vende të tjera, por përmend edhe Endri Fugën, shefin e Departamentit të Komunikimit në qeveri, që e mohon një gjë të tillë.

EUROPE

Potential EU-Albania asylum deal could help keep Germany's Angela Merkel in power

Albania is reportedly open to hosting reception centers for individuals seeking asylum in the EU. The plan could help keep embattled German Chancellor Angela Merkel in power and placate her hard-line interior minister.



Sipas DW, opozita shqiptare, aludon në anën tjetër se qeveria do të hapë qendra të tilla me shpresën se kjo do ta përshpejtojë procesin e anëtarësimit të vendit në BE. Sipas Deutsche Welle, Shqipëria gjendet në trajektoren balkanike dhe ka dalje në Mesdhe. Porti i Durrësit ka kapacitet që të presë një numër të madh individësh që tentojnë të kalojnë detin dhe që mund të përcillen nga anijet e FRONTEX-it. Pasi të kenë mbërritur atje, individët që nuk kualifikohen për azil mund të riadhesohen, ndërsa ata që e fitojnë

azilin, mund të shpërndahen drejt BE-së.

Veç kësaj, Shqipëria nuk është anëtare e bllokut, çka do të thotë se rregullat e Shengenit nuk aplikohen. Vendi nuk është as pjesë e Marrëveshjes së Dublinit që përcakton rregullat e azilit. Sidoqoftë, është anëtar i NATO-s dhe një qendër antiterror është ngritur atje.

Por si mund ta ndihmojë Shqipëria kancelaren Merkel? Në takimin e fundit me kancelarin austriak Kurz, ministri i Brendshëm gjerman, Horst Seehofer tha se e

mbështet idenë e qendrave të pritjes jashtë BE-së. Një marrëveshje e mundshme me Shqipërinë mund të ndihmonte në zbutjen e tensioneve mes kancelares dhe ministrit të saj.

Kjo, nënvizon Deutsche Welle, do të plotësonte kërkesën e Seehoferit që aplikimet për azil të plotësoheshin jashtë BE-së. Kjo do të favorizonte partinë e tij në zgjedhjet e pritshme në Bavari, ndërsa koalicioni qeveritar do të rifitonte stabilitet. Shqipëria po ashtu do të fitonte nga kjo marrëveshje. Duke hapur qendrat e

pritjes, thotë Deutsche Welle, ajo do të fitojë mbështetje edhe nga forcat më konservatore të bllokut që janë skeptike për fillimin e bisedimeve të anëtarësimit.

Në anën tjetër, pyetur nga BIRN, një zyrtar i Këshillit të Europës iu përgjigj me 'jo' pyetjes nëse ka apo jo një plan për bazë dizbarkimi refugjatësh në Shqipëri dhe mohoi gjithashtu që një plan i tillë të jetë kusht për hapjen e negociatave për anëtarësim. Zyrtari i Këshillit të Europës tha se koncepti i “qendrave rajonale të dizbarkimit”, për të cilat flitet në draftkonkluzionet e takimit të Këshillit më 28 qershor, nuk lidhet me Shqipërinë dhe se është ende një koncept në zhvillim.

“Jo. Rajonet nuk janë identifikuar ende sepse ne po flasim vetëm për mundësinë e eksplorimit të këtij koncepti,” tha zyrtari përmes një emaili, i pyetur nëse ky koncept lidhet në ndonjë farë mënyre me Shqipërinë.

Pyetjes nëse Platforma e Dizbarkimit lidhet me ndonjë farë mënyre me vendimin e pritshëm të Këshillit për hapjen ose jo të bisedimeve për anëtarësim me Shqipërinë dhe Maqedoninë, vendim që pritet të merret gjithashtu më 28 qershor, zyrtari iu përgjigj gjithashtu prerazi “Jo”.

NZZ: Gjermania imponon zgjidhjen Kosovë - Serbi



Takimi i së dielës midis Presidentit të Serbisë Aleksandër Vucic dhe atij të Kosovës, Hashim Thaçi, me ndërmjetësimin e Federica Mogherinit në Bruksel mund të jetë fillimi i fundit i konfliktit shumëvjeçar mes Serbisë dhe Kosovës. Ata do të zhvillojnë bisedime lidhur me normalizimin e marrëdhënieve. Gazeta zvicerane Neue Zürcher Zeitung shkruan se marrëveshjet e deritashme janë përmbushur pjesërisht dhe thotë se baza e marrëveshjes është përgatitur nga Gjermania.

Ndonëse me plot ngarkesa nga e kaluara, 19 vjet pas përfundimit të luftës, të dy

presidentët synojnë të gjejnë një zgjidhje të përhershme të konfliktit. Aktualisht një njohje e plotë e Kosovës nga Serbia përjashtohet, pasi edhe më tej janë 5 vende të Bashkimit Evropian që nuk e kanë njohur Kosovën, ndërsa Moska është pengesë për anëtarësimin e këtij vendi në OKB, shkruan gazeta zvicerane Neue Zürcher Zeitung.

Një zgjidhje për problemin e Kosovës është ofruar nga diplomatët gjermanë. Ata kanë ofruar si bazë për negociatën, marrëveshjen e vitit 1972 midis ish Gjermanisë Demokratike dhe asaj Federale, e cila nga diplomatët gjermanë është adoptuar për

rrethanat lokale. Rezultat i marrëveshjes, që do të arrihet midis presidentit Thaçi dhe atij Vuçiq, do të jetë njohja faktike e Kosovës nga Serbia, por jo dhe njohja zyrtare. Sidoqoftë, sipas marrëveshjes, Serbia nuk do të pengojë më anëtarësimin e Kosovës në OKB. Si shpërblim, Serbia do të bëhet anëtare e BE-së pasi vetëm vendet që nuk kanë konflikte për çështje kufiri me fqinjët, mund të bëhen anëtarë të OKB-së.

Ndonëse në opinion po qarkullojnë edhe ide të tjerë për shkëmbim terriore, për këtë opion nuk duan të dëgjojnë Berlioni dhe Uashingtoni shkruan Neue Zürcher Zeitung. Në gjithë këtë vorbull, pozita e presidentit të Serbisë nuk është e thjeshtë, pasi ai po kundërshtohet nga Kisha ortodokse serbe. Në anën tjetër, ai i ka premtuar Berlinit se problemin me Kosovën do ta zgjidhë gjatë këtij mandate, si president i Serbisë.

Ndërkohë, ankesa nga të dyja palët kanë shkruar në adresë të ndërmjetësueses Federica Mogherini. Si Serbia ashtu dhe Kosova e kanë akuzuar atë se është shumë pasive dhe se po merret më shumë me çështje të tjera. Ndërkaq, mundësia për një konferencë ndërkombëtare për zgjidhjen e problemit të Kosovës është përjashtuar. Aleatët e Kosovës, kanë vlerësuar se kjo mbetet vetëm një dëshirë e Serbisë.

Liberalizimi rrezikohet nga shtetet e mëdha

Të martën ose të enjten e ardhshme pritet të publikohet raporti i Komisionit Evropian për përmbushjen e kriterit të fundit për liberalizimin e vizave për Kosovën, shkruan “Zëri”. Megjithatë, njohës të integritimeve thonë se edhe nëse KE-ja vlerëson se Kosova ka përmbushur kriterin e luftimit të krimit të organizuar e të korrupsionit dhe rekomandon heqjen e vizave, Kosova mund të mbetet pa liberalizim gjatë këtij viti. Kjo pasi ata vlerësojnë se disa shtete të rëndësishme si Franca, Gjermania, Holanda e Suedia janë të rezervuara në këtë proces dhe se mund ta bllokojnë vendimin në Këshill të Ministrave. Ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ditë më parë në një intervistë për gazetën “Zëri” ka thënë se presin se do të jepet vlerësimi i cili do t'i përmbajë të arriturat e institucioneve kosovare të luftës ndaj krimit të organizuar dhe të korrupsionit. Hoxha po ashtu ka thënë se kanë lobuar për të siguruar mbështetjen e vendeve anëtare, pasi lobimi është proces po aq i rëndësishëm gati sa edhe përmbushja e kriterëve.

Në prag të zgjedhjeve të përgjithshme dhe presidenciale të 24 qershorit, Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan ka pranuar se partia e tij në fuqi AKP mund të humbasë shumicën parlamentare

ERDOGAN: MUND TË HUMBASIM SHUMICËN PARLAMENTARE



Ky pohim i pazakontë i zotit Erdogan vjen ndërkohë që fushata e tij është goditur nga një sërë hapash të gabuar dhe një ecuri e dobët.

Të dielën e kaluar, Presidenti Erdogan mobilizoi më shumë se një milion mbështetës për tubimin e tij në Stamboll. Kjo ishte një nga sukseset e rralla në fushatën e zotit Erdogan, sepse pjesëmarrja në mitingjet e tij ka qenë shumë më e ulët se në fushatat e mëparshme.

Sipas njoftimeve, disa takime të Erdoganit u shtynë për shkak të pjesëmarrjes së dobët, diçka që është mohuar nga AKP. Njoftohet se zoti Erdogan i ka qortuar disa herë ata që kanë dalë në mitingje për shkak të mungesës së entuziazmit.

Vetëm disa muaj para se të kërkonte zgjedhje të parakohshme, Presidenti Erdogan bëri thirrje

për një reformë në shkallë të gjerë të partisë së tij, duke spastruar qindra zyrtarë.

Reforma hoqi shumë zyrtarë të njohur, veçanërisht në qytetet e Anatólias. Në këtë rajon janë shumë nga mbështetësit më besnikë të zotit Erdogan, të cilët e mbështetën presidentin vitin e kaluar duke bërë që të miratohej me rezultat të ngushtë referendumi për zgjerimin e kompetencave të tij.

Duke folur gjatë një transmetimi të përbashkët të drejtpërdrejt të kanaleve turke "ATV" dhe "A Haber" në aeroportin e ri të Stambollit, Erdoğan zbuloi se çfarë do të sjellë sistemi i ri.

"Në sistemin presidencial do të ulim numrin e ministrive në 16", tha Erdoğan.

Pastaj përmendi ministrinë të cilat do të mbesin, e të cilat janë: Ministria e Drejtësisë, Punëve të Brendshme, Mbrojtjes, Arsimit, Shëndetësisë, Energjisë dhe Burimeve Natyrore, Mjedisit dhe Planifikimit Urban, Kulturës dhe Turizmit, Rinisë dhe Sporteve, Thesarit dhe Financave, Transportit dhe Infrastrukturës, Punëve të Jashtme, Sociale dhe Familjes, Bujqësisë dhe Pylltarisë, Industrisë dhe Teknologjisë, dhe ajo e Tregtisë. Duke theksuar se sistemi i ri duhet të inkurajojë ndarjen e pushtetit, Erdoğan tha se lidhja midis

qeverisë dhe parlamentit do të reduktohet.

"Në sistemin e ri, qeveria do të jetë e autorizuar vetëm për dorëzimin e projekt-buxhetit parlamentar. Autorizimi për projektin parlamentar i referohet vetëm parlamentarëve", tha presidenti turk. Si një reformë tjetër brenda sistemit të ri qeverisë, Erdoğan tha se do të themelohen katër zyra të rëndësishme.

"Në fazën e parë, katër zyra për burimet njerëzore, investime, financa dhe transformimin dixhital do të mbajnë një përgjegjësi të madhe në modelin e ri, pasi do të jetë pothuajse stafi më i afërt i presidentit", tha Erdoğan.



Hyjnë në fuqi tarifatat e reja ndaj mallrave amerikane

Tarifatat shpaguese të Bashkimit Evropian ndaj mallrave amerikane hynë në fuqi dje (e premte), sulmi më i fundit ky ndaj politikës tregtare të Donald Trumpit. Taksat prekin artikuj me vlerë të përgjithshme 2,8 miliardë euro, duke shënjestruar edhe produkte të rëndësishme për SHBA-në si uiski, motoçikletat dhe lëngu i portokallit.

Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker kujtoi se si ishte Amerika ajo që vendosi e para tarifatat e reja që binin ndesh me logjikën dhe historinë. Pas Turqisë të enjten, edhe India vuri taksa mbi 29 produkte të importuara nga Shtetet e Bashkuara, përfshirë disa mallra bujqësore dhe të tjera prej alumini e çeliku.

Tarifatat e saj hynë në fuqi nga 4 gushti dhe godasin sidomos eksportet e bajameve. India është blerësi më i madh i bajameve amerikane në botë, ndaj kjo lëvizje pritet të rëndojë ndjeshëm mbi fermerët amerikanë.

Donald Trump e bëri realitet kërcënimin e tij duke përfshirë nga 1 qershori edhe BE-në në tarifatat e reja amerikane dhe lista e tij u zgjat veç të tjerash edhe me Kanadanë e Meksikën.

Por kundërpërgjigjet që po merr nga të gjitha anët bëjnë që të lindë pyetja: a e përballon dot vërtetë Amerika luftën tregtare me të gjithë?

Policia zvicerane, në gatishmëri gjatë ndeshjes kundër Serbisë



Kur Zvicra do luajë të premtën mbrëma kundër Serbisë në kuadër të Kupës së Botës, mund të vijë deri te tensionimi mes serbëve dhe shqiptarëve.

Policia është e vetëdijshme për përballjen, shkruan media zvicerane "Aargauer Zeitung", duke treguar edhe komentet fyese të tifozëve serbë pas publikimit të fotos nga Xherdan Shaqiri me atletet që kishin flamurin e Zvicrës dhe Kosovës, përcjell al-

binfo.ch.

"Ne kemi kryer analiza të rrezikshmërisë dhe kemi definuar lojën," tha zëdhënësi i policisë, Roland Pfister.

Përleshjet mes shqiptarëve dhe serbëve nuk janë histori e panjohur për shumë vende perëndimore. Gjatë përballjes mes Shqipërisë dhe Serbisë në Beograd në 2015, u raportuan një sërë incidentesh në disa qytete zvicerane.

PËRGATITET TAKIMI TRUMP-PUTIN

Njoftohet se po zhvillohen përgatitjet për një takim mes Presidentit të Shteteve të Bashkuara Donald Trump dhe Presidentit rus Vladimir Putin. Mediat citojnë dy persona që kanë dijeni mbi çështjen, por që kanë kërkuar të mbeten anonimë.

Takimi pritet të zhvillohet gjatë vizitës së Trump në Evropë muajin e ardhshëm. Të dy udhëheqësit mund të takohen përpara takimit

të NATO-s që mbahet në datat 11 dhe 12 korrik në Bruksel, ose pas vizitës së Presidentit Trump në Britani dy ditë më vonë.

Të mërkurën Shtëpia e Bardhë nuk pranoi të komentojë lidhur me këtë çështje dhe Këshilli Sigurisë Kombëtare nuk iu përgjigj një kërkesë të "Zërit të Amerikës" për komente.

Zëdhënësi i Putin, Dmitri Peskov gjithashtu nuk pranoi të ko-

mentoje gjatë një konferencë me gazetarët të enjten, por ai tha se këshilltari amerikan për Sigurinë Kombëtare John Bolton pritet të vizitojë Rusinë javën e ardhshme për të diskutuar rreth përgatitjeve.

Ende nuk dihet se ku do të zhvillohet takimi, por sipas disa mediave të huaja, udhëheqësit mund të takohen në një nga kryeqytetet evropiane, pas samitit të NATO-s.



Sipas disa raporteve Vjena është një vend i mundshëm.

Trump ka shprehur interes në rivendosjen e statusit të zotit Putin në skenën botërore. Më parë gjatë këtij muaji, në takimin e grupit të

shtatësheh që u mbajt në Kebek, ai propozoi që Rusia të rripranohet në Grupin e Tetë vendeve më të industrializuara të botës. Anëtarësi i Rusisë u pezullua pas aneksimit të Krimesë në vitin 2014.

Nën organizim të Klubit të shkërimtarëve "Jehona e Karadaku", të mërkurën në qytetin e Kumanovës filloi edicioni i parë i manifestimit kulturor "Pena ime". Të pranishëm në këtë manifestim ishin artistë e artdashës.

Drejtori i manifestimit, Fatos Rushiti, tha se përmes festivalit "Pena ime", synojnë t'i sfidojnë artistët, e sidomos ata të gjeneratave më të reja, që të tregojnë vlerat e tyre të pashprehura.

"Kumanova gjithmonë është shquar me emra të artit e kulturës të cilët i kanë tejkaluar kufijtë tanë. Zaten arti dhe kultura nga vetvetiu janë të pakufishëm. Klubi i shkërimtarëve "Jehona e Karadaku" si një ndër klubet më të vjetra në këtë veprimtari dhe e cila rreth vetes mbledh figurat më të njohura të artit dhe letërsisë shqiptare, sivjet ka vendosur që përmes festivalit "Pena ime" të sfidojë artistët e sidomos ata të gjeneratave më të reja që të tregojnë vlerat e tyre të pashprehura", deklaroi drejtori i Manifestimit "Pena Ime", Fatos Rushiti.

Manifestimin e shpalli të hapur ministri i kulturës, Asaf Ademi, i cili theksoi nevojën e mbështetjes së aktiviteteve të tilla kulturore, të cilat nxisin konkurrencën pozitive në mes artistëve dhe shtojnë vlerat e tyre artistike.

"Kam përshtypjen se kultura është mënyra më e mirë që këtë

KUMANOVË, ME SUKSES STRATOI "PENA IME"



zonë ta gjallërojë e t'i japë frymë dhe do të jetë ushqim, jo vetëm për ta mbajtur atë në jetë, por edhe për ta bërë diell që do të reflektojë gjithandej. Të nderuar organizatorë, të organizosh një manifestim artistik me këso përmasa është një arritje e jashtëzakonshme, aq më shumë se kjo është një ngjarje që organizohet për artistët që për mua janë qenie të veçanta që nuk të flasin me gjuhën e zakonshme të njerëzve të rëndomtë", theksoi ministri i kulturës, Asaf Ademi. Në konkursin e artit figurativ kishte gjithsej 23 artistë nga qytete të

ndryshme të Maqedonisë. Në këtë ekspozitë janë përfshirë piktura, grafika dhe skulptura. Juria kishte vendosur që "Pena e artë për pikturë" t'i takojë autores, Afërdita Kiki, për pikturën "Pa titull", e punuar në tekniken akril në pëlhurë; "Pena e artë për grafikë" iu nda Naim Idrizit, për grafikën me titull "Saksofonist", punuar në aktualitë dhe "Pena e artë për skulpturë" iu nda Ardian Kadriut, për skulpturën me titull "Corgu", punuar me gips të patinuar.

Manifestimi "Pena ime" gjatë ditës së enjte vazhdoi me poezinë.

Juria profesionale, në përbërje: Salajdin Salihu, Ahmet Selmanii dhe Sunaj Raimi, kishin vendosur që tre vendet e para t'ua ndajnë poetëve: Daim Miftarii, Kreshnik Sopaj dhe Arlind Farizi, kurse çmimin inkurajues - poetit të ri Epirot Ferati...

Pjesë e rëndësishme e aktivitetit interdisiplinar ishin edhe: Funda Ali (arti muzikor) dhe Hanife Islami (arti figurativ).

Nata e tretë (të premten) e manifestimit "Pena ime", iu dedikua muzikë klasike, ku artistët e rinj performuan vepra të papërsëritshme.



Bleona Qerreti luan me Nicolas Cage në filmin "221"

Tash e sa vite po jeton në SHBA, ku po ndërton karrierën e saj në atë vend. Bleona Qerreti ka punuar disa projekte në gjuhën angleze dhe vazhdimisht është e angazhuar në këtë drejtim. Por, së fundi ajo i ka hyrë edhe kinematografisë, duke aktruar në filmin me titull "221", i cili tashmë është publikuar në të gjitha platformat. Këtë gjë e ka bërë të ditur vetë këngëtarja përmes rrjeteve sociale, meqë rast falënderoi bashkëpunëtorët. Bleona shfrytëzoi rastin ta shkëpus një skenë nga ky film, ku shihet edhe ajo, e në këtë film aktronte edhe Nicolas Cage.



Në Johannesburg zbulohet një pikturë e Rubensit

Piktura e quajtur "Portreti i zotërisë", që mendohet të jetë bërë nga mjeshtri i vjetër flaman, Peter Paul Rubens, u gjet në Johannesburg. Kompania Stephen Welz & Co. e vlerëson atë deri në tetë milionë randë (500 mijë euro). Piktura ishte blerë nga një pediatër hebre më 1925. Ai u shpërngul në Afrikën e Jugut më 1932 me dy piktura, një të cilat e shiti. Ajo është punuar para 420 vitesh.

Më 2016 piktura e Rubensit e quajtur "Loti dhe vajza e tij" ishte më e shtrenjta e mjeshtërve të vjetër. Për të u dhanë 58 milionë dollarë.

Nis ristrukturimi i shtëpisë së vëllezërve Frashëri

Në një postim në rrjetet sociale, kryeministri Edi Rama ka njoftuar se ka nisur fillimi i punimeve për rikonstruksionin e shtëpisë muzeale të vëllezërve Frashëri.

Me një video të publikuar në Facebook, kreu i qeverisë ka uruar të gjithë ndjekësit e tij.

"Mirëmëngjes dhe me fillimin e punimeve për rimëkëmbjen muzeale të Shtëpisë së vëllezërve Frashëri dhe gjallërimin e një rajoni zemrek të historisë sonë kombëtare, ju uroj një ditë të bukur", shkruan Rama.



Ekspozitë e Institutit të modës "Izet Curri"



Instituti Ndërkombëtar i Modës "Izet Curri" për fundin e vitit shkollor organizon ekspozitë me kreacionet e punuara nga studentët. Ekspozita do të mbahet me 27 qershor, me fillim nga ora 19:00, në Galerinë Nacionale të Maqedonisë "Daut Pasha Hamam", informon Koha.

Këtë vit ekspozita do të organi-

zohet për nderë të njërit ndër mjeshtërve më të mëdhenj të modës në shekullin XX, Azzedine Alaïa. Instituti francez në Shkup, një ndër bashkëpunëtorët tanë më të mëdhenj do të ndajë 3 çmime për arritjen vjetore të studentëve. Kemi nderin t'ju kemi të pranishëm në ngjarjen më të rëndësishme të vitit për studentët tanë.

Fati i trishtë i Nannerl, motrës së gjenit Moxart

Maria Anna-n, të gjithë e thërrinin Nannerl. Ajo është e bija e Leopold dhe Maria Pertl Moxart, motra e gjenit të muzikës, Wolfgang Amadeus Moxart. I ati kishte filluar që t'ia mësonte notat në piano Nannerl, ndërsa Moxarti i shikonte duke imituar notat që ajo krijonte, shkruan lajmi.net Leopold përpigje që t'ia mësonte të dy më shumë për mu-

zikën duke i afuar me të si një mënyrë argëtimi, mirëpo duke mos lënë anash mësimet. Kështu, të dy fëmijët u treguan të suksesshëm në këtë drejtim duke treguar aftësi mahnitëse në instrumente.

Në vitin 1762, babai i tyre mori Nannerl, në atë kohë 11 vjeçare dhe Moxarti 6 vjeçar performuan në oborin mbretëror në Bavari, në

Munich ku edhe filluan paraqitjen e tyre të cilat pastaj vazhduan si një lloj turne nëpër Europë.

Kështu, ata takuan muzikantë e performues të ndryshëm të cilët patën ndikim në punën e tyre.

Mirëpo, karriera e Nannerl përfundoi në kohën kur ajo arrin moshën për t'u martuar, pasi që, në atë kohë konsiderohej se ajo nuk



duhet që të shfaqet më në publik, gjersa Mozarti vazhdon karrierën

edhe jashtë Austrisë së bashku me babin e tij.

SHKËNDIJA FILLOI PËRGATITJET NË SLOVENI

TRE MIQËSORE TË FORTA PËRPARA SFIDËS ME UELLSIANËT E TNS-së

Përpos përgatitjeve fizike, stafi teknik i ka kushtuar një vëmendje të veçantë edhe miqësoreve, nëpërmjet të cilave do të synohet që kuqezinjtë të jenë gati për ndeshjet e turit të parë përballë uellsianëve të Nju Saints. Testet do të zhvillohen ndaj kundërshtarëve mjaft të fort dhe me emër, Domzhale, Osijek dhe Vorskla



Shkup, 22 qershor - Pas Kukësit, edhe një tjetër skuadër shqiptare që luan në Ligën e kampionëve transferohet në Slloveni për fazën përgatitore. Kampioni i Maqedonisë dhe fituesi i Kupës, Shkëndija e Tetovës, ka nisur punën në Rogashka Sllatina, me ekipin që është stërvitur me ngarkesë të lartë. Përpos përgatitjeve fizike, stafi teknik i ka kushtuar një vëmendje të veçantë edhe miqësoreve, nëpërmjet të cilave do të synohet që kuqezinjtë të jenë gati për ndeshjet e turit të parë përballë uellsianëve të Nju Saints. Testet do të zhvillohen ndaj kundërshtarëve mjaft të fort dhe me emër. Duke nisur nga dueli i kësaj të shtune

përballë sllovenëve të Domzhales, pjesë e së cilës janë dy futbollistët shqiptar, Agim Ibraimi dhe Husmani. Miqësoret do të vijojnë më 27 qershor me kroatët e Osijekuit, skuadër në të cilën aktivizohet edhe futbollisti i Kombëtares së Shqipërisë, Eros Grezda, ndërsa

më datën 1 korrik është planifikuar testi i fundit përballë ukrainasve të Vorskla Poltavas. Pas miqësoreve dhe mbylljes së përgatitjeve në Slloveni, Shkëndija do të jetë gati për duelet me Nju Saints, me sfidat e para të turit të parë kualifikues në Çam-

pions që luhen në datat 10 dhe 11 korrik, ndërsa takimet e kthimit në datat 17 dhe 18. Nëse kualifikohet në turin e dytë, ekipi tetrovar do të luajë me fituesen e çiftit ndërmjet gjeorgjianëve të Torpedo Kutaisi dhe moldavëve të Sheriff Tiraspol.

DËSHTON KALIMI I BATHËS TE SHKËNDIJA

Idriz Batha i dha lamtumirën Partizanit disa ditë më parë. Sezonin e fundit ai mbajti edhe shiritin e kapitenit të të kuqve, por vendosi ta mbyllë aventurën me këtë ekip dhe ta vazhdojë karrierën diku tjetër. Batha ishte shumë pranë kalimit te Shkëndija e Tetovës në kampionatin maqedonas, por siç bën të ditur "vipsport.al" kjo lëvizje duket se ka dështuar, pasi palët



nuk kanë arritur akordin. Ndoshta mund të ketë ndonjë takim tjetër, por ka pak shanse që të ketë një marrëveshje. E ardhmja e mesfushorit duket më shumë e lidhur me Kampionatin e Shqipërisë, por nuk është se ka ndonjë pistë konkrete këtë moment dhe duhet pritur për të mësuar se çfarë fanelle do të veshë Batha sezonin e ardhshëm.

IMERI LARGOHET NGA FC SHKUPI, KRYESIA E AKUZON

Shkupi akuzon: Imeri u largua tinëzisht!

Shkup, 22 qershor - Skuadra e FC Shkupi nga dita e enjte po qëndron në Turqi ku është duke zhvilluar përgatitjet për ndeshjen me Glasgow Renxher në kuadër të Liga Evropës. Mirëpo, në kampin bardhekaltër gjatë ditës së djeshme ka ndodhur një gjë e pazakontë. Në fakt, siç bënë të ditur vetë klubi nga Çairi, Omar Imeri pa asnjë paralajmërim, është larguar nga baza Bollu e Turqisë, gjë që i ka shqetësuar drejtuesit e saj, përfshi këtu edhe stafin teknik dhe bashkëlojtarët. Sipas tyre, Omar Imeri është larguar në mënyrë tinëzare, ndërsa në faqen e tyre zyrtare përshkruajnë të gjithë ndodhinë. "Kryesia dëshiron të njoftojë të gjithë dashamirët e klubit dhe futbollit se pas shumë bisedimeve dhe orvatjeve që Imeri të mbetet



në klub, ai veç më si duket më herët kishte ndarë mendjen për të qenë jashtë familjes së madhe të ekipit bardhekaltër. Ne si Kryesia e klubit nuk arritëm në asnjë mënyrë që të gjejmë gjuhë të përbashkët me Imerin, edhe pse e afirmuam atë në një lojtar të pjekur,

duke ardhur ai si lojtar 'Calceto', siç e dimë në futboll 'balloni' prej lagjeve të Çairit. Imerin e morëm pa përvojë, e ushqyem dhe e promovuam në Ligën e Parë, duke i dhënë shansin që të luajë për ekipin e seniorëve, e që kjo i ndihmoi atij të jetë pjesë edhe e reprezenta-

cionit U21 të Maqedonisë, por Imeri në mënyrë tinëzare u largua nga klubi, duke mos udhëtuar me skuadrën për në Turqi. Padyshim se gjatë bisedimeve që kishim me të, i kemi dëgjuar kërkesat e tij, duke i plotësuar çdo kërkesë që kishte, që rrallë ka ndonjë futbollistë me shumë përvojë në kampionatin tonë, por kjo tregonte planet pas shpine që i kishte bërë Imeri. E gjithë kjo lojë me futbollistin Omar Imeri, është lojë e përbashkët e kurdisur nga menaxheri i tij, i cili me ngulm ka insistuar largimin e tij nga klubi ynë. Nuk duhet harruar se FC Shkupi është klub me traditë 90 vjeçare, ndërsa jemi të vetëdijshëm për krizën që kishte pas rikthimit në Ligën e parë. Por duhet kuptuar edhe një gjë, se Shkupi tani po rikthehet

Balliu drejt Turqisë

Rënia e Metz nga kategoria elitare në Francë ka bërë që drejtuesit të ndryshojnë strategjinë e shpenzimeve. Për këtë, disa prej futbollistëve mund të lënë skuadrën gjatë merkatos së transferimeve. Një prej emrave është edhe Ivan Balliu. Mbrojtësi i Kombëtares shqiptare vlerësohet si alternativa e duhur nga skuadra e Goztepes në Turqi. Duke parë tratativat, skuadra franceze ka caktuar çmimin e largimit të tij. Bëhet fjalë për rreth 900 mijë euro, që duhet të paguajë skuadra turke në rast se do të kërkojë shërbimet e shqiptarit. Për Goztepen, aktualisht janë edhe dy emra të tjerë si alternativa për linjën e djathtë të mbrojtjes: Ahmet Oguz Gençelbirliqi dhe Lamine Gasama nga Antaliaspori.

Ndoj te Bresha deri në vitin 2022

Emanuele Ndoj rinovon kontratën me Breshën në Serinë B. Mesfushori 21-vjeçar shqiptar ka nënshkruar marrëveshjen e re që e mban të lidhur me skuadrën lombarde edhe për 4 vitet e ardhshme. Në komunikatën e publikuar nga klubi italian shkruhet: "Breshën është e lumtur të njoftojë se është arritur marrëveshja me Emanuele Ndojin për rinovimin e kontratës deri në vitin 2022. 21-vjeçari vendosi të qëndronte edhe pse kishte oferta nga skuadra të tjera. Emanuele i urojmë shumë fat dhe suksese në të ardhmen me fanelën e "dallëndysheve", thonë nga klubi italian. I lindur në vitin 1996, Ndoj gjatë sezonit të fundit është aktivizuar në 22 ndeshje me Breshën, ndërsa me Shqipërinë ka shënuar një gol, atë në miqësoren e humbur 1-4 me Ukrainën.

HIJET E DOPINGUT NË BOTËTOR

RUSIA, NJË NGA SKUADRAT MË TË KONTROLLUARA



Distance covered per 90 mins

Aleksandr Golovin	Russia	11,853
Alexander Samedov	Russia	11,679
Iury Gazinsky	Russia	11,392
Toni Kroos	Germany	11,251
Christian Eriksen	Denmark	11,242
Trezeguet	Egypt	11,103
Hector Herrera	Mexico	11,073
Koke	Spain	11,026
Abdalla Said	Egypt	11,018
Thomas Meunier	Belgium	10,851
Roman Zobnin	Russia	10,850
Jesse Lingard	England	10,727
Amr Warda	Egypt	10,705
Ellyes Skhiri	Tunisia	10,682
Joshua Kimmich	Germany	10,674

Ekipi i trajnerit Stanislav Çerçesov ka befasuar shumë tifozë dhe kritikë që nga ndeshja e parë, duke fituar më shumë besueshmëri pas një periudhe të keqe të kaluar para fillimit të Kupës së Botës. Por, nga ana tjetër e botës, është dikush që ka ngritur dyshime për formën e mirë fizike të Golovin me shokë. Siç ka bërë të ditur e përditshmja britanike "Telegraph", pas fitoreve me Arabinë Saudite dhe Egjiptin, kreu i agjencisë antidoping amerikane (USADA), Travis Tygart, i ka kërkuar FIFA-s kontrolle më të kujdesshme antidoping

Dy fitore të njëpasnjëshme me tetë gola të shënuar dhe vetëm një të pësuar. Rusia ka siguruar kualifikimin dhe është kombëtarja me formën më të mirë fizike në këtë Botëtor. Ekipi i trajnerit Stanislav

Çerçesov ka befasuar shumë tifozë dhe kritikë që nga ndeshja e parë, duke fituar më shumë besueshmëri pas një periudhe të keqe të kaluar para fillimit të Kupës së Botës. Por, nga ana tjetër e botës, është

dikush që ka ngritur dyshime për formën e mirë fizike të Golovin me shokë. Siç ka bërë të ditur e përditshmja britanike "Telegraph", pas fitoreve me Arabinë Saudite dhe Egjiptin, kreu i agjencisë antido-

ping amerikane (USADA), Travis Tygart, i ka kërkuar FIFA-s kontrolle më të kujdesshme antidoping. Nga të dhënat e para që kanë lidhje me paraqitjen fizike të lojtarëve që luajnë në Botëtor, në krye të renditjes të "distancës mesatare të përshkuar në nëntëdhjetë minuta" janë plot tre lojtarë të vendasve. Një rezultat ky që e ka bërë të dyshojë Tygart: "Kombëtarja ruse duhet t'i nënshtrohet testeve të tjera për të garantuar integritetin e Botëtorit, – ka thënë numri

një i USADA-s. – Rregullat ndërkombëtare parashikojnë që përmirësimet e papritura në paraqitjet e një skuadre duhet të monitorohen". Kreu i agjencisë amerikane, i cili ka qenë një nga të parët që ka akuzuar Lens Armstrong, ka drejtuar gishtin nga zotët e shtëpisë. Gjithsesi, asnjë përgjigje zyrtare nuk ka ardhur nga kombëtarja ruse. Ndërkohë, FIFA ka bërë të ditur se, Rusia ka qenë "një nga skuadra më të kontrolluara" në prag të Botëtorit.

I ati debuton në Botëtor, fëmija shpërthen në lot



Fitorja e Suedisë ndaj Koresë së Jugut, në ndeshjen e parë të nordikëve të Kupës së Botës, ka pasur një moment të veçantë, sidomos për djalin e sulmuesit Markus Berg.

Berg luajti për herë të parë në një Botëtor, gjatë fitores 1-0 në Grupin F, me golin e shënuar nga Andreas Granqvist, me penallti. Djali i tij katër vjeç padyshim që ka qenë ndër më të emocionuarit për këtë hap gjigant në karrierën e të atit. Ka qenë pikërisht bashkëshortja e Berg, Josefine, e cila ka postuar një video në "Instagram" ku fëmija katër vjeç duke në lot, në shkallët e stadiumit "Nizhny Novgorod", në momentin që Berg zbriti në fushë. Qëndërsulmuesi i Suedisë pritet të jetë titullar edhe të shtunën ndaj Gjermanisë, ndërsa ndeshja e fundit e grupit është të mërkurën ndaj Meksikës.

Mashtroi me biletat, rrezikon 10 vite burg



Ish drejtori sportiv i Anzhit, Eldar Issayev, u arrestua nga autoritet ruse për shitje të biletave false të Botëtorit. Ai do të qëndrojë prapa hekurave ndërsa 18 gushti është cak-

tuar si datë për nisjen e procesit gjyqësor ndaj tij. Issayev, sipas shtypit rus, rrezikon deri 10 vite burg, pasi u kishte ofruar agjencive kineze të turizmit 3500 bileta false për turistët e vendit të madh aziatik. Nga ky mashtrim, Issayev, që ka qëndruar në krye të Anzhit nga janari deri në nëntor të 2017-ës, kishte përfituar rreth 900 mijë euro. Gjithçka u zbulua kur me dhjetëra tifozë kinezë që kishin mbërritur në Rusi, nuk u lejuan të futeshin në stadium për të ndjekur sfidën Argjentinë – Islandë, sepse biletat e tyre nuk rezultat të vërteta. Një reagim i ambasadës kineze në Moskë nxiti ndërhyrjen e autoriteteve, që arrestuan menjëherë Issayev.

Pogba: Kante dhe Matuidi i kanë nga 15 mushkri



Pol Pogba thotë se mesfushorët N'Golo Kante dhe Blaise Matuidi duhet të kenë "15 mushkri" për shkak të mbulimit të mrekullueshëm të lojës ndaj Perusë. Kante dhe Matuidi kanë shkëlqyer duke qenë të pathyeshëm në mesfushë. Pogba ishte i përfshirë në golin e Mbappes që ishte goli i vetëm i takimit, por mesfushori pati kompliment interesant për bashkëlojtarët e tij në

mesfushë. "Dyshja ime me Kanten? Është aq lehtë të luaj me Kanten. Ai është gjithandej në fushë. Ai duhet të ketë 15 mushkri. Blaise ka 15 mushkri po ashtu. Unë jam i rrethuar me talent të mëdhenj", deklaroi Pogba. Edhe pse Franca ka qenë larg prej të qenurit impulsive deri tash në Kampionat Botëror, Pogba thotë se së paku ata e kanë kryer punën duke i fituar dy ndeshjet e para.

Publicitet

Është humbur dëftesa e klasës së 8-të e personit Bushra Hajrulla të SH.F. "Liria" - Shkup dhe njëkohësisht shpallet e pavlefshme.

Ndjej dhimbje për këtë humbje, nuk lexuam ndeshjen mirë. U kërkoj falje njerëzve që erdhën deri këtu për të na parë të mundemi. Si trajnerë mundohemi të gjejmë një ekip sa më të mirë që të shoqërojë Mesin

Argjentina çaloi edhe në ndeshjen e dytë në grup ndaj Kroacisë, me rezultatin e thellë 3-0, teksa ka zvogëluar shpresat për një kualifikim të mundshëm për në turin tjetër. Lidhur me këtë dështim ka folur edhe trajneri i Argjentinës, Horge Sampaoli, i cili ka marrë mbi vete përgjegjësitë e humbjes, por nuk duket se do të largohet nga drejtimi i anijes pa u zyrtarizuar lamtumira nga turneu. "Dështimi është përgjegjësi e imja. Nuk mund t'i mbetet Kaballeros. Na kushtoi shumë goli i parë. Ndjej dhimbje për këtë humbje, nuk lexuam ndeshjen mirë. U kërkoj falje njerëzve që erdhën deri këtu për të na parë të mundemi. Si trajnerë mundohemi të gjejmë një ekip sa më të mirë që të shoqërojë Mesin. Në pjesën e dytë u munduam që të hidhnim në fushë lojtarë sa më të mirë që të ndryshonim diçka, por nuk ia dolëm. Kishim shumë shpresa që do të kualifikoheshim falë kësaj ndeshje por nuk ia dolëm. Nuk na eci plani i lojës dhe tani do të kapemi pas çdo shansi minimal që na ka mbetur. Unë kam luajtur me fanellën e përfaqësueses së Argjentinës dhe më dhemb, më shemb shumë që nuk u paraqitëm ashtu siç dëshironte populli argjentinës.", ishin fjalët e tij në konferencën për shtyp pas sfidës.

MEDIAT ARGJENTINASE: MESSI TË (RI) LARGOHET NGA KOMBËTARJA

Humbja me rezultatin e thellë 3-0 e Argjentinës ndaj Kroacisë është shumë vështirë të kapërdihet nga tifozët bardhekaltër dhe jo vetëm, pasi ishin të paktë ata që e mendonin një gjë të tillë. Kjo ndeshje ishte një dështim edhe për yllin e kësaj skuadre, Lionel Messin. Ndërkohë, kritikantët janë të ashpra edhe nga gazetari i mirënjohur Fernando Niembro, i cili kërkon që fituesi i pesë herë i Topave të Artë të heqë dorë nga kombëtarja. "Messi, u largove nga kombëtarja përpara disa vitesh. Nuk do të ishte keq po ta bëje sërish", është titulli i opinionit të Niembros, i cili kritikon Messin se është bërë "zot" i përfaqësueses duke zgjedhur miqtë e tij. Ndërkohë, gazetari e kritikon Messin edhe për vetë faktin se nuk bën diferencën me Argjentinën ashtu siç bën me Barcelonën. Ja kush janë frazat më të rënda për Messin:

HORGE SAMPAOLI MERR PËRGJEGJËSINË

HUMBJA MË DHEMB, U KËRKOJ FALJE NJERËZVE

"Messi u bë 'zot' i kombëtares argjentinase. Është trajneri i skuadrës sonë dhe vendosi që të fusë në formacion miqtë e tij. Dhe ja ku e kenë rezultatin.

Një ekip pa forcë, një ekip i vishkur, një ekip pa zemër. Messi, kërkojmë prej teje që të luash me zemër. Je lojtari më i mirë. Kur ekipi rrëzohet, më të mirit të skuadrës i kërkohet që të japë dhe atë që nuk ka. Ti nuk e dhe. Boll më me mikun tënd Maskerano. Një herë e dhe dorëheqjen nga kombëtarja, nuk do të ishte keq që ta bëje sërish këtë gjë", ka shkruar Niembro.

MODRIÇ: ISHIM PERFEKTË, FITORJA E MERITUAR!

Fitorja e Kroacisë ndaj Argjentinës mbrëmjen e së premtes mban vetëm një emër dhe ai është ylli i Real Madridit, Luka Modriç, pasi shënoi një supergol nga distanca, duke lënë të shtangur portierin bardhekaltër të Argjentinës. Kroacia në plotë kuptimin e fjalës e dominoi ekipin e Messit, teksa e mundi me rezultatin e thellë 3-0. Lidhur me këtë ndeshje ka folur vetë mesfushori kroat: "Objektivi më i rëndësishëm është realizuar", ka thënë fillimisht Modriç. "Ne duhet tani të shkojmë ndeshje pas

ndeshje. Kjo fitore do të rrisë besimin tonë për ndeshjet e ardhshme. Do të jetë e vështirë, por le të shmangim euforinë, t'i mbajmë këmbët fort në tokë për t'u përgatitur për ndeshjet e ardhshme. Në fund, fitorja jonë duket e lehtë, por nuk ishte aq e lehtë, mendoj se fitorja ishte plotësisht e merituar, por nuk ishte e lehtë. Ne kemi luajtur një lojë perfekt dhe keni nevojë për një lojë perfekt për të mposhtur një ekip të tillë të shkëlqyer. Ne e ndalëm Messin, e ndaluan atë për ta marrë topin pasi ai është lojtari i tyre më i rrezikshëm", deklaroi kapiteni kroat.

Zllatko Daliç

Sot djemtë ishin fantastikë, grupi ishte kompakt në fushë. Ne ia dolëm t'i shënonim 3 gola Argjentinës, tani nuk kemi frikë asnjë tjetër. Objektivin tonë të parë e arritën me kualifikimin, tani duhet të qëndrojmë të qetë, të përlur, të disiplinuar dhe ajo që ka më shumë rëndësi, të uritur për më tepër. Vetëm kështu mund të ecim përpara. Jemi 22 lojtarë fantastikë

MEDIAT BOTËRORE: MODRIÇ MERITON "TOPIN E ARTË"

Shtypi ndërkombëtar vlerësoi performancën e Luka Modriç kundër Argjentinës. Ato e caktojnë mesfushorin kroat si fitues të qartë në betejën e "10", që ai kishte me Leo Messin, gjatë përplasjes direkte të Botërorit të Rusisë, ku ballkanasit fituan 3-0 ndaj amerikano-jugorëve. Madje, prestigjiozja sportive italiane, "La Gazzetta dello Sport" e konsideron kroatin e Real Madridit të denjë për "Topin e Artë".

Daily Mail (Angli) – "Me Messin e izoluar, Modriç e ka fituar betejën e numrave "10". Messi mbeti krejtësisht në hijen e Luka Modriç, numrit 10 të Kroacisë, i cili ishte në qendër të çdo gjëje që ndodhi në ndeshjen Argjentinë-Kroaci. Ai ishte motori dhe strategu i Kroacisë. Ishte një bashkim i çuditshëm i forcave mes Barcelonës dhe Real Madridit: Rakitiç dhe Modriç dominuan ritmin në mesfushë. Çdo herë që Kroacia doli përpara, Modriç bëri spektakël me topin. Falë dirigimit të tij, argjentinësit u rruhdhën dukshëm prapa".

La Gazzetta dello Sport (Itali) – "Modriç dhe Rakitiç janë mesfushorët, që vranë ëndrrat e Argjentinës, të enjten në mbrëmje. Udhëheqësi i Kroacisë ishte Luka Modriç, i cili e meriton "Topin e Artë", por ndoshta kurrë nuk ta fitojë".

BBC (Angli) – "Pjesa e dytë ishte një shfaqje e vazhdueshme mbresëlënëse e dominues nga Kroacia, e ndriçuar nga një moment i magjiksë së numrit të vet 10, e mjeshtrit Luka Modriç, që me të drejtë u shpall njeriu i ndeshjes".

Ole (Argjentina) – "Kroacia, me mjeshtrin e



lojës, Luka Modriç, tregoi dhembët e saj ndaj Messit me shokë. Argjentina, mesa duket, nuk e konsideron gabim që të dështojë që në grupe, në Botërorin e Rusisë".

The Guardian (Angli) – "Luka Modriç e plotësoi kryeveprën e tij për golin më të mirë të Botërorit".

Daily Telegraph (Angli) – "Modriç dhe Rakitiç kontrolluan mesfushën dhe diktuan ritmin e lojës ndaj Argjentinës, e cila, nga ana tjetër, ishte shumë e dëshpëruar, si peshku pa ujë".

L'Equipe (Francë) – "Luka Modriç luajti një ndeshje të shkëlqyeshme në mesfushë, i shoqëruar sidomos nga Ivan Rakitiç, po ashtu i shkëlqyeshëm. Ata vallëzuan në fushë, ndaj një kombëtareje argjentinase me dobësi shqetësuese".


Bild (Gjermani) – "Një gol ëndërrash nga ylli i Real Madridit, Luka Modriç, shënnoi fitoren kroate ndaj Argjentinës. Kroacia, kombëtarja me futbollin më të qartë deri tani në këtë Botëror".



Pasion e dashuri e zjarrtë, Botërori pushtohet nga puthjet

Tifozë amatorë dhe të thekur, ultras dhe dashamirës të futbollit, kanë udhëtuar për në Rusi kësaj vere. Kuptohet lehtë, kanë shkuar atje për të shijuar Kupën e Botës, të 21-tën në radhë, teksa nuk kanë hezitur aspak edhe të shprehin dashurinë e tyre me puthje të zjarra

nëpër tribuna, por jo vetëm. Fotot më poshtë ju tregojnë anën tjetër të kësaj Kupe Bote, që ka ngërthyer mbarë globin para ekranit të televizorit, ndërsa ata që kanë mundur të jenë në Rusi, po e shfrytëzojnë ekspeditën më së miri edhe në këtë drejtim.



DASHI 21. mars - 20. prill

Kjo ditë do ju gjejë më produktiv dhe krijues, qoftë në sferën profesionale edhe në atë sentimentale. Gjatë kësaj të premtjeje, mund të nxirri konkluzionet e duhura, sa i takon zgjedhjeve që keni bërë në të kaluarën.

DEMI 21. prill - 21. maj

Duhet të jeni të gatshëm për të ndryshuar disa parametra nga rutina juaj e përditshme, me qëllim arritjen e një objekti të ri. Kjo është një periudhë që favorizon transformimet e mëdha dhe që do ju lejojë që të gjeni forcën dhe gjallërinë që ju duhet.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Do të keni mundësi që të merrni të reja të mëdha në sferën profesionale dhe kjo gjë do ju lejojë që të vlerësoni më mirë projektet tuaja dhe aktivitetet e reja për këtë verë. Në dashuri do të jeni tejet romantikë dhe të sigurtë në ndjenjat tuaja.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Jeni mjaft të mërziur, ndoshta për shkak të mungesës së stimulave, ku së fundmi e shihni veten mjaft dembel dhe të përhumbur në mendime. Megjithatë kjo e premtje, premtion të rena interesante sa i takon takimeve dhe jetës sentimentale.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Kjo periudhë nuk ju lejon që të guxoni tepër dhe gjithçka për shkak të një sërë çështjesh të pazgjidhura, të cilat duhet ti trajtoni me kujdesin maksimal. Në raport me partnerin duhet të jeni më të kuptueshëm dhe arsyeshëm, pasi në të kundërt rrezikoni shumë.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Gjatë kësaj dite duhet të jeni më të hapur ndaj partnerit/es tuaj, sidomos nëse gjatë javëve të fundit keni tentuar që të zgjidhni disa situata të tensionuara të mbetura pezull. Favorizohen çështjet që kanë të bëjnë me paratë.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Parashikohet një ditë e qetë dhe relaksuese, e cila do ju lejojë që të jetoni më qetësisht të gjitha raportet tuaja ndërpersonale. Tregohuni të besueshëm ndaj bashkëpunëtorëve tuaj, pasi realizimi i një projekti të ri ka nevojë për mbështetjen e të gjithëve.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Kjo e premtje do të jetë mjaft e favorshme për të nisur një fazë të mbushur me aventura dhe rreziqe, të cilat do të kapërcehen për të arritur një qëllim. Jini më shumë kurajozë dhe mos u druani të përbaleni me frikërat tuaja.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Kjo ditë do të jetë mjaft frenetike nga pikëpamja profesionale, ku do të ndiheni gati për tu përballur me negociata të mëdha. Edhe në dashuri po jetoni një periudhë shumë interesante, e cila do të favorizojë zgjedhjet e duhura.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Kjo do të jetë një e premtje shumë produktive e cila do ju lejojë që të nxirri në pah kapacitetin tuaj drejtues. Do të jeni shumë impulsiv dhe kjo gjë do ju lejojë që të zhblokooni disa situata, sidomos në dashuri. Megjithatë duhet të tregoheni shumë të kujdesshëm me fjalët që do të thoni.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Mundohuni që të mos lodheni shumë, pasi së fundmi do të ndiheni të sforcuar, vetëm e vetëm për të arritur objektivat tuaja në vendin e punës. Duhet të keni më shumë besim në kapacitetin tuaj, pasi intuita juaj nuk do ju zhgënjëjë. Kjo e premtje favorizon takimet e reja.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Do të jeni të gatshëm që të kaloni më shumë kohë me familjen dhe partnerin/en. Gjatë kohëve të fundit keni qenë të dekurajuar në punë dhe në raportet ndërpersonale. Disa çështje burokratike, duhen përballuar me kujdesin maksimal.

PESË RESPEKTIVISHT NJË VIT PA TË DASHURIT DHE TË PAHARRUARIT TANË



NEKIE DHE ADI VINCA (1933 - 2013) (1927 - 2017)

Do të kalojnë vitet, por kujtimet për Ju do të mbeten përjetësisht në zemrat tona sepse Ju jeni pjesë e jetës sonë të përditshme. Dashuria, bujaria, zemërgjerësia dhe respekti që Ju kishit mbeten përgjithmonë në kujtesat tona.

Ju kujtojnë me respekt: Djemtë, nusët, nipat e mbesat, stërmbesa e stërnipi, vëllezërit e motrat, kushërinjtë, dashamirët e shumë nga Struga, Veleshta, Dollogozhda, Prishtina, Zvicra, Austria, Amerika e Suedia.

Koha Koha	VEPËR E ELIZABET BISHOP-it	MBRETI SHQIPTAR	MAL NË GREQI	PARAQITJA KONVEKSE E SIPËRFAQES						
HUNDA E VARKËS A NJË LUNDRE										
PAJISJE TRANSME- TIMI										
KOMPOZITORI YNË, KOÇI										
EMRI, FAMA										
VOLT		FIJE PAMBUKU, LESHI etj. GJYSMË- RRETH			NUMRI QË VJEN PAS SHTATËS	DRAMË E SHEKSPIRIT FILM I SPILBERGUT	MASË ANGLEZE PËR GJATËSI	ITALIA		TENSIONIMI I MARRË- DHËNIEVE NDRËKOMP- BËTARE
EVA HERCIGOVA			FIJA E PERIT NË QIRI KOMIKU ANGLEZ, ATKINSON						LITËR SINJAL NË RAST RREZIKU	
NJË GJË E RRALLË (shq.)								SIMBOLI KIMIK I ARIT MONEDHË E VJETËR GREKE		
BANJË NË PIRINEJE				MANEKINJA, MEKFERSON LLOJ FIGURE STILISTIKE			MARKË AUTOMOBILI LLOJ PALME AFRIKANE			
RRETH MË I MADH I TOKËS (gjeog.)							FUTBOLLISTI ANGLEZ, NIKI ENA ME TË CILËN PIMË UJË			
FAHRENHEIT		AKTORJA FRANÇEZE, ZHIRARDO FLORI					SHESH PUBLIK NË QYTET MË MERR ETJA			
FILMI I PARË SHQIPTAR					TË FOLURIT E NJË KRAHINE NËNË (turq.)					
ARI (fregj.)			NAFAKË (shum.) HOTEL NË AUTOSTRADË						QYTET NË ZVICËR	FRANCA DËSHMI (lat.)
HIDROGJEN		PIKTORI FRANÇEZ, KLOD THURA (NJË SHPORT etj.)					QË ESHTË LËNË I LIRË, PA FRE NËNAT			
RREGULL NË MATEMATIKË							GRUP I GJUHËVE INDIANE PALESTINIAN LIBERATION ORGANIZAT.			
					MILJE JAPONeze	HOLLOJ TEHUN E THIKES ELI FARA				
NUMRI PAS TETËS	AKTORI, DENI ... VITO METËR			NJERI PRAKTIK, KONKRET INDUKSION						
FILMI I ENTONI MINGELES										

ZGJIDHJET: PLOR, RELE, AKIL, NAMI, V, PE, O, EH, FITILLI, L, RARITETI, AU, ARO, EL, GOLF, EKVATOR, BAT, F, ANI, AGORA, TANA, E FOLME, OR, FATET, F, H, MONE, AZAT, TEOREME, UTO, NËNTA, MPREH, DE, REALIST, MALI I FTOHTË, FJALËKR, KLASIK, PANTOMIMA, HUNGARORING, A, SELANIK, R, LFP, LAROS, PA, ARI, LIT, TON, KOLEGJ, OBATI, AMILLI, NEPAL, SIKI, HIRËSI, LUFTHANZA.

Autizmi po shkaktohet nga alergjitë në ushqime



Autizmi vërtet mund të shkaktohet nga alergjitë e ushqimit, sipas hulumtimeve të reja. Një studim i pothuajse 200.000 fëmijëve zbuloi se ata që ishin në spektrin e çrregullimeve kishin më shumë se dy herë e gjysmë më shumë gjasë se të tjerët të vuanin një intolerancë ushqimore. Zbulimi shton një numër gjithnjë në rritje të provave që sugjerojnë se një sistem imunitar i mosfunksionimit ngre rrezikun e çrregullimit të spektrit të autizmit (ASD). Studimi i Universitetit të Iowa-s është një nga të paktët për të parë alergjitë ushqimore - përveç reaksioneve të lëkurës dhe të frymëmarrjes - duke forcuar lidhjen ndërmjet autizmit dhe alergjive

Gruaja që mund të sfidojë Donald Trumpin



Samiti i Singaporit midis Donald Trump dhe Kim Jong Un nuk ka qenë një moment i rëndësishëm vetëm për drejtuesit e dy shteteve. Ambasadorja e SHBA-së në OKB, Nikki Haley po shijon tani benefitet e diplomacisë së saj të ashpër dhe të vendosur. Fox News ka publikuar një shkrim të autorit Jessica Tarlov, ku Haley promovohet si gruaja e parë që mund të marrë kontrollin e 'Shtëpisë së Bardhë', pas dështimit të Hillary Clinton. "Diplomacia pas skenë e ambasadores Heley, në veçanti me ambasadorët e Kinës dhe të Rusisë, e bëri të qartë se nuk po bënim shaka (për krizën me Korenë e Veriut)", ka thënë për Fox News një zyrtar amerikan.

Jessica Tarlov thekson se nuk është dakord me të gjitha qëndrimet e Nikki Haley, por pavarësisht kësaj, është dukshme që ambasadorja ka një pozitë të fuqishme. Ekspertët e konsiderojnë ish-Guvernatoren e Karolinës së Jugut si një "ylli roku surprizues" në administratën e Trump dhe vlerësojnë qëndrueshmërinë e saj.

Koha e fivës, sa mund të hamë dhe pse i nevojiten organizmit?

Tani sapo ka përfunduar koha e fivës të parë dhe do të presim shumë shpejt fivët e gushtit që kanë tjetër shije dhe janë më të vegjël. Sigurisht, koha e reçelit më të mirë është me fivët e dytë. Mirëpo, dimë gjithashtu që fiku është një nga frutat me më shumë sheqer dhe sasia e konsumit të tij duhet të jetë e kufizuar. Pikërisht kaloritë, janë arsyeja pse duhet të hamë sa më pak, me gjithë tundimin që na shkaktojnë, sidomos pasditeve kur sapo i kemi nxjerrë nga frigoriferi. Megjithatë, kanë vitamine dhe veti laksative e antiinflamatore...Me proshutë kru-

do apo djathëra të kripur, fivët, qofshin gliko, qofshin të freskët, janë shumë të shijshëm.

Në përbërje të tij, përveç ujit, fiku përmban shumë sheqer; nuk mungojnë as fibrat dhe mineralet (mes të cilave potasiumi që rregullon presionin e gjakut, fosforin, hekur, sodium etj). Fiku është i pasur në vitaminë B (B1, B2, B3 dhe B6), C dhe A. Rregullimi i sistemit tretës është një karakteristikë e tij. Shikimi, lëkura dhe kockat përfitojnë gjithashtu prej konsumit të fikut. Tani, siç ju thamë që në fillim, mos e teproni!



Google tani e di dhe se kur do të vdesim



Google po shihet të gjitha aspektet e jetës digjitale të njerëzve, që nga emaili, kërkimet, hartat, kalendarët, çka do të thotë se di jo pak për 1.17 miliardë përdoruesit e tij. Por tashmë, gjiganti teknologjik do ta dijë se kur do të vdisni. Grupi i risisë së krijuar, Medical Brain, po përdor një mënyrë të re algoritmi të inteligjencës

artificiale për të parashikuar gjasat e vdekjes mes pacientëve spitalorë. Në një dokument të publikuar në revistën "Nature" thuhet me detaje se si algoritmi parashikues përdoret grupe të mëdha të dhënash për të përcaktuar nëse pacientët e sëmurë do të mbijetonin në dy spitale të ndryshme. Për të parashikuar vdekshmërinë e pacientëve, Medical Brain i Google ishte 95 për qind i saktë në spitalin e parë dhe 93% i saktë në spitalin e dytë. "Kjo ishte dukshëm më e saktë se modelet tradicionale të parashikimeve. Këto tejkalluan modelet tradicionale. Parashikimet klinike në të gjitha rastet. Ne besojmë se kjo përpjekje mund të përdoret për të na dhënë një shkallë të saktë parashikimi për raste të ndryshme klinike", thuhej në dokument.

930 - Themelohet parlamenti më i vjetër në botë, ai i Islandës.

1295 - Papa Bonifazi VIII arrin në Romë.

1298 - Duka Albreht von Habsburg zgjedhet Mbret i Gjermanisë.

1532 - Henri VIII dhe Fransa I nënshkruajnë traktat të fshehtë kundër perandorit Karli V

1565 - Durgut Reis, udhëheqës i Flotës Osmane, vdes gjatë rrethimit të Maltës.

1724 - Rusia dhe Turqia nënshkruajnë Traktatin e Konstantinopojës.

1760 - Beteja e Landshut Silesia: Austria mund Prusinë.

1848 - Kryengritja e përgjakshme e punëtorëve në Paris.

1944 - Tomas Mani bëhet shtetas amerikan.

1950 - Parlamenti zviceran refuzon të drejtën e votës për gratë.

1956 - Xhamal Abdel Naser zgjidhet kryetar i Egjiptit.

1960 - Japonia traktat të sigurimit me SHBA.

1990 - Moldavia shpall pavarësinë.

KALENDARI HISTORIK 23 QERSHOR

Astronauti Neil Armstrong fillimisht donte që të merrte me vete gjatë misionit në Hënë një top futboll, por NASA e pengoi pasi e cilësoi atë si një simbol joamerikan.



Futbolli është sporti më i luajtur dhe më i parë në Tokë. Futbolli si lojë e ka origjinën në Kinë rreth vitit 476 Para Erës Sonë. Më shumë se 80 për qind e topave të futbollit të gjithë botës, prodhohen në Pakistan.



PINGUINËT ME SYZE

Një polic shef njërin që po ngiste një kamion të mbushur me pinguinë mbrapa. E ndalon dhe i thotë: - Ku shkon me gjithë këta pinguinë ti? Çoju në kopsht zoologjik. Të nesërmen polici duke drejtuar trafikun, sheh prapë këtë tipin me kamionin plot me pinguinë dhe secilit i kishte vënë syze. E ndalon prapë dhe i thotë:

- Ore ti, nuk të thashë ti çojë në kopsht zoologjik dje?
- I çova mor shef - përgjigjet shoferi.
- Sot po i çoj në plazh.

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS



Marrëdhënia ideale ka të bëjë me dy gjëra, e para, të gjesh ngjashmërinë, e dyta, të respektohet ndryshimet. (John Lennon)